



EDITORIAL

Shtetformësia e njëanshme e shqiptarëve



A sillen shqiptarët e Maqedonisë si shtetformues, ashtu siç parapëlqejnë të jenë në praktikë? Ose, me çfarë sensi të shtetformësisë sillen ata aktualisht sa i përket zgjidhjes së kontestit që Greqia vazhdon të mos e pranojë emrin "Maqedoni"? Askush nuk e ka dhënë një shpjegim kompetent se për çfarë arsye shqiptarët me kaq komoditet kanë hequr dorë nga përfshirja e tyre në çështjen e emrit të shtetit ku edhe ata jetojnë

Fq.2

PROFILE

Heroi i Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore

Fq.16

RAJON

Masakra që ndërroi fatin e Kosovës por që mbeti pa drejtësi

Fq.14



RATIFIKOHET MARRËVESHJA PËR FQINJËSI TË MIRË ME BULLGARINË PA PROBLEME ME FQINJËT



"Marrëveshja është e rëndësishme për shkak se të dyja palët janë inkurajuar të dalin nga llogoret, veçanërisht në rajonin tonë, i cili është i ngarkuar me histori dhe është e rëndësishme se i jep një vetëbesim të caktuar shoqërisë sonë", theksoi ministri Dimitrov. Nga BDI, për Marrëveshjen me Bullgarinë foli deputeti Artan Grubi, duke thënë se partia e tij inkurajon Qeverinë që të mbyll të gjitha çështjet e hapura me fqinjët

Fq.3

Ndotësit do të largohen nga trafiku


Shkup, 15 janar - Nga fillimi i verës pritet të hyjnë në fuqi ndryshimet e reja ligjore me të cilat të gjitha veturat do të fitojnë ngjitëse ekologjike me ngjyra të ndryshme që do të tregojnë se cili automobil sa ndot ambientin. Kjo nënkupton se me ndryshimet ligjore do të shënohet çdo veturë në varësi prej emetimit të gazrave ndotës. Në këtë mënyrë do të seleksionohen veturat që do të largohen nga komunikacioni

gjatë ndotjes së madhe të ajrit. Këtë e parashikojnë ndryshimet e Ligjit për vetura që për momentin i përgatit Ministria e Ekonomisë. Aktualisht po punohet në propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për vetura, ose në intervenimet ligjore që duhet të inkorporohen në Ligjin për vetura dhe aktet nënligjore të Ligjit për vetura thonë nga Ministria e Ekonomisë. Ligji duhet të jetë...

Fq.7



EDITORIAL

SHTETFORMËSIA
E NJËANSHME
E SHQIPTARËVE

Emin AZEMI

A sillen shqiptarët e Maqedonisë si shtetformues, ashtu siç parapëlqejnë të jenë në praktikë? Ose, me çfarë sensi të shtetformësisë sillen ata aktualisht sa i përket zgjidhjes së kontestit që Greqia vazhdon të mos e pranojë emrin "Maqedoni"? Askush nuk e ka dhënë një shpjegim kompetent se për çfarë arsye shqiptarët me kaq komoditet kanë hequr dorë nga përfshirja e tyre në çështjen e emrit të shtetit ku edhe ata jetojnë.

Ka shumë zëra (të vetmuar) intelektualësh që insistojnë në bashkëpjesëmarrje shqiptaro-maqedone në tejkalimin e këtij kontesti, duke e ndërlidhur emrin e shtetit edhe me historinë e vetë shqiptarëve. Angazhimi momental i politikanëve shqiptarë në këtë problematikë, ka karakter më tepër teknik e protokollar, se sa substancial. Në shoqërinë shqiptare nuk është zhvilluar kurrfarë debati publik nëse pajtohen apo jo shqiptarët me zgjidhjet e ofruara eventuale nga pala greke dhe ajo maqedonase (ndonëse asgjë zyrtare nuk ka) sa i përket emrit që duhet ta ketë në të ardhmen shteti i tyre.

Ky (vetë)përjashtim i shqiptarëve nga debati për emrin, rrënjët i ka te një vetëdije e deplasuar se gjoja emri i shtetit qenka ekskluzivitet vetëm i maqedonase etnike, diçka që lidhet vetëm me identitetin dhe historinë e tyre dhe se ky problem nuk po i prekka edhe interesat jetike e afatgjata të shqiptarëve.

Nëse na qenka kështu, atëherë me çfarë të drejtë shqiptarët kërkojnë të jenë shtetformues në një shtet me një emër që nuk po reflektuara edhe sensibilitet e tyre historike, sociale, kulturore e etnopsikologjike. Na duket i cinguar ky pretendim për shtetformësi nëse identiteti shtetëror paraqitet si diçka i huaj, si diçka që "nuk ka të bëjë me neve", si diçka që është problem "vetëm i tyre". Tani kur atributet e shtetformësisë po forcohen edhe me elementin gjuhësor, shqiptarët nuk kanë nevojë të jenë kaq zemërgjerë dhe të heqin dorë nga diçka që iu takon. Shikimi i njëanshëm i problemit të emrit, ka instaluar, pa drejtë, një diskutim plot dilema, duke e (vetë)përjashtuar elementin shqiptar nga narrativi mijëra vjeçar i gjithë asaj që lidhet me Maqedoninë parahelene dhe postkomuniste.

Thirrjet në Shkup e Athinë për referendum në të cilët "populli do të vendoste për emrin e ardhshëm", bazohen në realitete që i prodhon politika e ditës, por jo në realitete që korrespondojnë me gjendjen faktike. Ata që i bëjnë këto thirrje, sigurisht që nuk i kanë parasysh edhe shqiptarët, dhe me automatizëm sikur duan të prejjudikojnë mosinteresimin e tyre për këtë çështje që qenka "ekskluzivisht greke e maqedonase".

Fundja, a kanë faj të tjerët pse ne vet nuk jemi të interesuar të jemi bashkëpjesëmarrës të një çështjeje, që lidhet edhe me interesat tona jetike nacionale, historike, kulturore etj.

Pastaj ku mbeti shtetformësia aq shumë e proklamuar?

MEKANIZMAT E ZBATIMIT TË GJUHËS SHQIPE

"Edhe një herë e lexova ligjin e miratuar për përdorimin e gjuhëve dhe për hir të së vërtetës duhet thënë se me këtë ligj gjuha shqipe bëhet zyrtare. Këtë e garanton neni 1 i këtij ligji paragrafi 2 dhe gjithë nenet tjera të ligjit. Definimi elegant zyrtarizimi që buron nga kallëpi kushtetues. Ky ligj pra e zyrtarizon gjuhën shqipe. Mbetet që mekanizmat e zbatimit t'i qartësojnë do mjegullime të vogla dhe sigurisht në një të ardhme edhe definimi i plotë në kushtetutë si gjuhë shqipe dhe jo si përqindje. Të kihet kujdes që gjithë operacionalizimi i mëtutjeshëm të bëhet në bazë të formulimit të nenit të parë dhe gjithë zbatimi të bazohet nga ky formulim", shkruan në FB, publicisti Bardhyl Zaimi.



TETOVA, NJË FSHAT I MADH

"Në Tetovë nuk ka dhe nuk do të ketë as transport publik dhe as kinema. Sepse transporti publik dhe kinematë janë në qytete, a Tetova ka 2 dekada që nuk është qytet, por një fshat i madh", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti dr.Armend Nuhiu.



KURESHTJA PERVERSE

"Në çdo vend të civilizuar ekziston një respekt për sferën private, sidomos të njerëzve të sëmurë. Në mesin e shoqërisë kosovare ka individë (jo pak, për fat të keq), që këtë rregull etik nuk e respektojnë. Viktimë e kësaj 'kureshtjeje perverse' të shoqëruar edhe me 'lutje' barbare tani është edhe ish-kryeministri i Kosovës, dr. Isa Mustafa. Më kujtohet se pasi presidenti dr. Ibrahim Rugova në vitin 2005 doli para popullit dhe tregoi se vuante nga kanceri, një hajvan politik i Prishtinës në një gazetë të Beogradit kërkonte që Rugova të largohet nga skena politike, sepse i ka kaluar koha. Nuk kishte pikë respekti për një njeri të sëmurë rëndë. Në vitin 2013 drejtuesi i Formulës 1 Michael Schumacher u lëndua rëndë gjatë skijimit. Që nga atëherë, mediat në Gjermani dhe vende të tjera të civilizuar e kanë respektuar sferën private dhe nuk kanë raportuar për këtë tragjedi. Për herë të fundit në shtator 2014 mediat kanë cituar menaxheren e tij, e cila ka thënë se 'Schumi' është duke vazhduar rehabilitimin në shtëpinë e tij! Merrni pak shembuj!", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Enver Robelli.



NJË KURORË DEGËSH ULLIRI

"Unë zakonisht nuk bëj postime rasti në Facebook, por sonte më lejoni të bëj përjashtim. Dua t'i them dy fjalë për Basri Çapriqin, t'u a bëj të ditura atyre që e njohën dhe atyre që nuk e njohën. Sonte letërsia shqipe mbeti pa njërin nga poetët e saj më të mirë. Ishte mjeshër i vargut dhe i metaforës, poet i ndjeshmërisë së hollë dhe mendimit të thellë. Do të më mungojë poezia e tij, që gjithmonë më ngjante me një kurorë degësh ulliri... Të falëm mik, nuk jetove gjatë, por nuk bëre jetë pa vlerë", shkruan akademik Mehmet Kraja, në shenjë kujtimi për poetin që ndërroi jetë, Basri Çapriqi.



MEDIACitate

Reforma në drejtësi është prioritet kryesor për integrimin dhe për thithjen e investimeve është shprehur ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, në takimin e tij në Suedi me Karin Enstrom, kryetar e komisionit për BE në parlamentin suedez. Të dy bashkëbiseduesit i kushtuan vëmendje të veçantë procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, duke ndarë mendimin për rëndësinë që ka politika e zgjerimit në vendet e rajonit të Ballkanit dhe procesin e reformave në të. Znj. Enstrom rikonfirmoi qëndrimin suedez për anëtarësimin e rajonit, përfshirë Shqipërinë, në Bashkimin Evropian bazuar në meritë dhe plotësimin e kriterëve për këtë qëllim.

(Top Channel, 15 janar)

Ministri i Fondacioneve dhe Çështjeve Fetare të Palestinës, Jusuf Edis tha se Izraeli gjatë vitit 2017 ka kryer mbi një mijë shkelje ndaj vendeve të shenjta islame dhe të krishtera. Edis në një deklaratë për media në qytetin Ramallah tha se Mesxhid-i Aksa çdo muaj po i nënshtrohet më shumë se 40 shkeljeve dhe sulmeve të ndryshme. Sipas tij, kolonët hebrej hyjnë në Mesxhid-i Aksa ku lexojnë Talmud dhe bëjnë thirrje për rrënimin e Aksa-së. Ai bëri të ditur se xhamitë në Kudsin Lindor dhe Bregun Perëndimor janë sulmuar 12 herë kurse varrezat 15 herë. Edis tha se qeveria e Izraelit gjatë vitit 2017 ka ndaluar 645 herë thirrjen e ezanit në xhaminë Ibrahim të qytetit El Halil.

(Anadolu Agency, 15 janar)

Krye-Brexitasi Nigel Farage e elektrizoi Britaninë e Madhe dhe gjysmën e Evropës me kërkesën e tij për një referendum të ri për Brexitin. Farage deklaroi se një votim i ri do t'u mbyllte përfundimisht gojën atyre që "ankohen dhe qahen" për daljen nga BE. Kundërshtarët e tij në Britaninë e Madhe dhe në pjesën tjetër të BE u ngazëllyen: po të kenë mundësi britanikët të votojnë edhe njëherë për BE, rezultati do të ishte krejt tjetër, besojnë ata: Brexiti mund të anulohet. Por Farage tani është tërhequr. Në botimin online të "Daily Telegraph" ai shkruan ndërkohë: "Për ta thënë qartë, unë nuk dua një referendum të dytë".


(DW, 15 janar)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË ËSHTË EPIGRAFIA?

Epigrafia është shkencë që merret me studimin e mbishkrimeve në gjuhë e alfabetë që nuk përdoren më sot dhe që zakonisht zbulohen nga arkeologjia. Mbishkrimet mund të jenë me karakter publik (ligje, dekrete), me karakter fetar dhe me karakter privat. Me interes për studimet shqiptare janë epigrafia greke e vjetër e romake, epigrafia paleokristiane, epigrafia bizantine dhe osmane. Midis mbishkrimeve të shumta

që janë zbuluar në Shqipëri, një vlerë të veçantë kanë mbishkrimet në gjuhën greke të gjetura në qytetet antike: Dyrrah e Apoloni (gurë varri me emra ilirë etj.) që dëshmojnë për praninë e popullsisë ilire në këto dy koloni greke; mbishkrimet e gjetura në Butrot, Amantia, Bylis, Dimal etj., si dhe mbishkrimet latine me prejardhje nga qytetet që u shndërruan në koloni romake (Skodra, Dyrrahu, Bylisi, Butroti dhe rrethinat e tyre).



RATIFIKOHET MARRËVESHJA PËR FQINJËSI TË MIRË ME BULLGARINË

PA PROBLEME ME FQINJËT

"Marrëveshja është e rëndësishme për shkak se të dyja palët janë inkurajuar të dalin nga llogoret, veçanërisht në rajonin tonë, i cili është i ngarkuar me histori dhe është e rëndësishme se i jep një vetëbesim të caktuar shoqërisë sonë", theksoi ministri Dimitrov

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 15 janar - Më shumicë votash prej 61, një kundër dhe një abstenim, deputetët të hënën në seancën e 36 plenare votuan ratifikimin e shumëpërtur të Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë. Ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov para votimit tha se marrëveshja në fjalë mbulon interesat e përbashkëta nacionale të të dyja shteteve dhe popujve. "Është fakt që çështjet delikate dhe të vështira midis dy vendeve fqinje është vështirë të dakordohen dhe as tek ne e as në Bullgari nuk janë tërësisht të kënaqur me tekstin. Marrëveshja i mbulon interesat tona dhe të palës bulgare. Ka një simbolikë të bukur, sepse në ditën e sotme - Bullgaria ishte vendi i parë që e njohu Pavarësinë e Maqedonisë. Është shumë e rëndësishme që para ratifikimit të marrëveshjes, në praktikë kemi ndryshim thelbësor të marrëdhënieve tona", deklaroi Dimitrov. Ai shtoi se të dyja palët janë zotuar të dalin nga llogoret e historisë dhe se marrëveshja i jep një vetëbesim të caktuar shoqërisë në vendin tonë. "Marrëveshja është e rëndësishme për shkak se të dyja palët janë inkurajuar të dalin nga llogoret, veçanërisht në rajonin tonë, i cili është i ngarkuar me histori dhe është e rëndësishme se i jep një vetëbesim të caktuar shoqërisë sonë", theksoi ministri Dimitrov. Nga BDI, për Marrëveshjen me Bullgarinë foli deputeti Artan



BULLGARIA E PËRKRAH MAQEDONINË PËR NË BE DHE NATO

Bullgaria e përkrah Maqedoninë për anëtarësim në BE dhe në NATO, tha ambasadori bullgar në Shkup, Ivan Velikov Petkov para Komisionit për çështje evropiane në Parlamentin e Maqedonisë, duke i prezantuar prioritetet e Kryesimit bullgar me BE-në. "Bullgaria i përkrah përpjekjet e Qeverisë së Maqedonisë, të opozitës dhe të shoqërisë qytetare për arritjen e qëllimeve më të larta kombëtare - anëtarësim në BE dhe në NATO dhe kjo të ndodh gjatë kohës kur me Këshillin Evropian



kryeson pikërisht Bullgaria", tha Velikov Petkov. Por, që të ndodh kjo, potencoi ambasadori bullgar, duhet të zbatohen prioritetet urgjente reformuese. Ai paralajmëroi se Bullgaria gjatë kryesimit me BE-në, do të punojë në rritjen e kontakteve mes vendeve nga Ballkani Perëndimor dhe përmirësimin e marrëdhënieve mes tyre. Ambasadori Velikov Petkov ka shprehur edhe kënaqësi që Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Bullgarinë sot është vendosur në ratifikim në Kuvendin e Maqedonisë.

Grubi, duke thënë se partia e tij inkurajon Qeverinë që të mbyll të gjitha çështjet e hapura me fqinjët. Kjo, sipas Grubit, do të jetë përcaktuese krahas plotësimit të reformave brenda vendit që Maqedonia të hapë negociatën për anëtarësim në BE dhe për hyrje në NATO. "Kjo Qeveri dhe shumica parlamentare janë të përkushtuara në marrëdhëniet e mira midis komuniteteve dhe në përmirësimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me fqinjët tanë që do të mundësojë integrim më të shpejtë dhe qasje drejt marrëdhënieve euroatlantike. Përmes realizimit të këtyre politikave nuk varet vetëm perceptimi i Brukselit, por e përforcon edhe sigurinë tonë. Me mbulljen e çështjes me fqinjët, sovraniteti dhe karakteri unitar i vendit mbeten të pacenueshme. Për shkak të kësaj, ne të gjithë nga BDI dhe komuniteti shqiptarë në tërësi e përkrahim mbylljen e çështjeve

të hapura me fqinjët", deklaroi Grubi. Deputeti i BDI-së theksoi se gjatë 2018-ës, të gjithë duhet të duhet të përkushtohemi në anëtarësimin e plotë të Maqedonisë në NATO dhe në BE dhe prandaj, shtoi Grubi, duhet që të përdoret e njëjta energji edhe për zgjidhjen e kontestit me emrin me Greqinë.

MUHIQ: MARRËVESHJA KA LËSHIME NDAJ PALËS BULLGARE

Siç dihet, Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Bullgarinë u nënshkrua më 1 gusht të vitit 2017 nga ana e kryeministrave të dy shteteve, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov, për shkak të përforcimit të marrëdhënieve të ndërsjella miqësore, avancimin e fqinjësisë së mirë, zhvillimin e marrëdhënieve të gjithanshme, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Marrëveshja është rezultat i procesit dakordues pesëvjeçar të grupeve të punës të dy MPJ-ve dhe paraqet

marrëveshjen e nënshkruar në vitin 1990. Ndryshe, deputeti që abstenoj nga radhët e LSDM-se ishte akademiku i njohur Ferid Muhiq. Ai në foltore tha se nuk do të votojë kundër, por do të abstenojë nga fakti se kjo Marrëveshje, sipas Muhiqit, ka lëshime ndaj palës bulgare, që nuk janë të zakonshme për marrëveshje ndërshtetërore. Po të hënën deputetët me shumicën votash miratuan edhe Ligjin për amnisti, me çka me hyrjen në fuqi të këtij Ligji - 670 të burgosur me nga 6 muaj burgim do të falen plotësisht, ndërkaq 3097 të burgosurve do t'iu hiqet dënimi rreth 30 %. Ligji për amnisti nuk i përfshin personat e dënuar me burgim të përjetshëm, për vrasje, përdhunim dhe pedofili, për terrorizëm, dhe vepra penale kundër shtetit, atyre kundër rendit dhe sigurisë publike dhe vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. "Amnistia nuk i përfshin të dënuarit të cilët deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji është urdhëruar nxjerrje të fletëarrestit për shkak partishmërisë së organeve të ndjekjeve penale", thuhet në Ligj. Por rezerva ndaj Ligjit për amnisti ka shprehur Avokati i Popullit, Ixhet Memeti. Ai për javoren maqedonas "Fokus", ka thënë se Ligji në fjalë i vë në pozitë të pabarabartë të burgosurit, meqë procedurat do të zhvillojë gjykata e jo burgjet. "Ligji ka mangësi pasi të



ARTAN GRUBI

Kjo Qeveri dhe shumica parlamentare janë të përkushtuara në marrëdhëniet e mira midis komuniteteve dhe në përmirësimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me fqinjët tanë që do të mundësojë integrim më të shpejtë dhe qasje drejt marrëdhënieve euroatlantike. Përmes realizimit të këtyre politikave nuk varet vetëm perceptimi i Brukselit, por e përforcon edhe sigurinë tonë



IXHET MEMETI

Ligji ka mangësi pasi të burgosurit i vë në situatë të pabarabartë, që do të thotë se do të ketë zbatim selektiv. Problemet do të shfaqen gjatë procedurave që do të zhvillojnë Gjykatat e jo burgjet, siç është praktikuar deri më tani

burgosurit i vë në situatë të pabarabartë, që do të thotë se do të ketë zbatim selektiv. Problemet do të shfaqen gjatë procedurave që do të zhvillojnë Gjykatat e jo burgjet, siç është praktikuar deri më tani", ka thënë Memeti. Ai ka pasur kritikë ndaj Qeverisë për mospërfiljen e vërejtje që ka parashtruar i Avokatit të Popullit.

ZHBOGAR: VMRO TË KTHEHET NË PARLAMENT

Ndryshe deputetët e VMRO-së nuk morën pjesë të hënën në seancë plenare ndonëse pritej të ishin prezent gjatë votimit të Marrëveshjes me Bullgarinë. Deputetët VMRO-së kanë paralajmëruar se do të prezantojnë në seancë vetëm në ditën kur do të mbajë fjalim Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e që do të jetë enjtja e kësaj jave. Ndërkohë, ambasadori i BE-së në Shkup, Samuel Zbogor i ka bërë thirrje opozitës maqedonase që të kthehet në Parlament. "Reformat kërkojnë dialog të vazhdueshëm ndërmjet të gjithë segmenteve të shoqërisë, prandaj opozita duhet të marrë pjesë në votimin e ligjeve që janë shumë me rëndësi në udhëtimin e Maqedonisë drejt Evropës. Në periudhën që vjen pritjet zbatimi i Marrëveshjes së Përzihos dhe zbatimi i reformave", deklaroi të hënën Zbogor. Ndryshe, opozita maqedonase bojkoton Parlamentin në shenjë revolte ndaj parburgimeve të ish funksionarëve të tyre për ngjarjet e përgjakshme të 27 prillit.

MIRATOHET AMNISTI, 670 TË DËNUAR DO TË DALIN NGA BURGJU

Parlamenti i Maqedonisë dje e miratoi Ligjin për amnisti me të cilin do të lirohen nga vuajtja e dënimit me burg përafërsisht 670 persona me gjykim të plotfuqishëm me burgim deri në gjashtë muaj, ndërsa 3097 personave do t'iu zvogëlohet dënimi për 30 për qind. Amnistia nuk do të vlejë me personat e dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për burgim të përjetshëm, për vrasje, dhunim dhe pedofili, për terrorizëm dhe vepra penale kundër shtetit, për vepra penale kundër rendit dhe qetësisë publike, si dhe për vepra penale kundër njerëzimit

dhe të drejtës ndërkombëtare. Amnistia nuk do të vlejë edhe për personat të cilët veprat penale i kanë kryer pas 20 shtatorit të vitit të kaluar. Ministria e Drejtësisë gjatë përgatitjes së Ligjit i ka pasur parasysh kushtet në institucionet ndëshkuese-përmirësuese si institucione të cilat duhet të mundësohen dhe të sigurojnë risocializim të suksesshëm të popullatës së dënuar. Në Republikën e Maqedonisë pas Pavarësisë janë sjellë më shumë ligje për amnisti në vitin 1991, 1999, 2002 dhe në vitin 2003 (i rishikuar në vitin 2004).

SHEKERINSKA PËR VIZITËN
E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
TË NATO-S

VIZITA E STOLTENBERGUT MESAZH MË VETE

"Arritëm që Maqedonisë t'i hapim shans të ri. Vizitën e shohim si mundësi që Maqedonia të prezantohet në dritë më të ndryshme, si shtet i cili i zgjidh problemet e tij, i cili punon në prioritetin e tij, dhe i cili realisht beson se anëtarësimin në NATO dhe BE që nënkupton siguri më të madhe dhe prosperitet më të madh të qytetarëve të Maqedonisë", tha Shekerinska

Shkup, 15 janar - Vizita e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s në Maqedoni, Jens Stoltenberg, është mesazh vetë më vete. Kjo do të thotë se gjatë gjashtë muajve të kaluar arritëm që Maqedoninë ta kthejmë prapa në rrugën euro-atlantike dhe arritëm t'i neutralizojmë të gjithë ato lajme të këqija, të cilat në vazhdimësi në vitet e kaluara vinin në Maqedoni. Këtë të hënën e deklaroi ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, duke e vlerësuar vizitën vijuese të sekretarit të përgjithshëm të Aleancës në vend. "Arritëm që Maqedonisë t'i hapim shans të ri. Vizitën e shohim si mundësi që Maqedonia të prezantohet në dritë më të ndryshme, si shtet i cili i zgjidh problemet e tij, i cili punon në prioritetin e tij, dhe i cili realisht beson se anëtarësimin në NATO dhe BE që nënkupton siguri më të madhe dhe prosperitet më të madh të qytetarëve të Maqedonisë", tha Shekerinska. Sipas saj, qëllimi kryesor i vizitës është që edhe Stoltenberg të dëgjojë edhe nga ana jonë çka është ajo që e kemi punuar dhe se cilët janë planet tona. "Në pjesën e mbrojtjes ka se me çka të lavdërohem - me të dhëna për buxhet të rritur në mbrojtje, me pjesëmarrje tanimë të rritur në misionin e

NATO-s në Afganistan dhe me politika të reja të transparencës dhe integritetit të cilët tregojnë se Maqedonia të jetë anëtare e vërtetë e NATO-s fillimisht duhet të sigurojë integritet, transparencë dhe përgjegjësi në funksionimin e tyre", tha Shekerinska. Në pyetjen se si e vlerëson problemin me emrin për hyrjen e vendit në NATO, ajo thotë se "problemi me emrin për fat të keq u bë një nga problemet e shumtë të cilët NATO i vlerësoi në raportin e fundit". "Vizita e sekretarit të përgjithshëm nuk është e dhuruar, por e merituar, kjo nuk është e mjaftueshme për anëtarësim, por megjithatë tregon se

jemi nisur në rrugë të vërtetë. Stoltenberg nuk do ta zgjidhë problemin me emrin, ai do ta dërgojë mesazhin se kur një shtet dëshiron të bëhet anëtare e NATO-s dhe i tërheq hapat e vërtetë - e garanton qeverisjen e të drejtës dhe vlerat themelore të cilat janë në bazën e NATO Aleancës, se atëherë ajo e fiton shansin për anëtarësim në NATO", vlerësoi Shekerinska. Ajo theksoi se në gjashtë muajt e kaluar Maqedonia ka treguar mënyrë të re të sjelljes, kulturë më të ndryshme politike, dhe treguam se atë që do ta paralajmërojmë dhe premtujmë përmbushet dhe bëhet realitet.

OSMANI: JANARI DHE SHKURTI, MUJ KYÇ PËR PUNËN E PARLAMENTIT

Janari dhe shkurti janë muajt ku në Parlament duhet të tregojmë kapacitet demokratik dhe bashkëpunim mes politikave, tha sot zëvendëskryeministri i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani. Ai, këtë e deklaroi në ratifikimin e Marrëveshjes për Fqinjësi të mirë me Bullgarinë në Kuvend, duke shtuar se është optimist kur bëhet fjalë për zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë. Sipas Osmanit, janari dhe shkurti janë muajt kyç për punën në Parlament. "Nëse i zbatojmë reformat dhe e zgjedhim kontestin me emrin, do të marrim rekomandim pa kusht për fillimin e bisedimeve me Bashkimin Evropian. Kjo është mundësi që nuk guxon të humbet", deklaroi ai.

Rusia pranon emrin që dakordohet mes Athinës dhe Shkupit

Moskë, 15 janar - Intensifikimi i bisedimeve për emrin e Maqedonisë është i lidhur me dëshirën e SHBA-së që ta futin këtë vend në NATO, vlerësoi ministri i Punëve të Jashtme Sergej Llavrov në pres konferencën e MPJ-së ruse në Moskë. Llavrov tha se pas "një gjumi të gjatë", bisedimet tani janë intensifikuar dhe të gjithë e kanë të qartë se pse - nuk bëhet fjalë për afrimin e dy popujve ballkanikë, por dëshirën e disave që një prej tyre të bëhet anëtare e NATO-s. Ministri rus konsideron se Maqedonia e cila dëshiron të jetë pjesë e NATO-s do të duhet që të bëjë përfundime, për dallim nga Greqia e cila tashmë është anëtare e Aleancës. I pyetur nëse Moskë do ta pranojë emrin e ri eventual të Maqedonisë, që nga Rusia është njohur me emrin kushtetues, Llavrov u përgjigj se "çfarëdo lloj emri që do të dakordojnë Athina dhe Shkupi, emri i cili zyrtarisht do të futet në kushtetutën e Maqedonisë, do të pranohet nga ana e Rusisë".

Nimic: Ka momente pozitive në Shkup dhe në Athinë

Athinë, 15 janar - Mediatori i Kombeve të Bashkuara në negociatat për emrin midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, Methju Nimic në intervistën për televizionin kombëtar grek ERT tha se nuk ka propozim të ri për emrin dhe se në takimin e ri, të caktuar për më 17 janar në Nju-Jork do të dalë me propozim-ide për të cilat është diskutuar edhe në të kaluarën. Ekzistojnë momente pozitive në Shkup, thotë Nimic, duke shtuar se Qeveria e re në Shkup është shumë e interesuar që ta zgjidhë këtë çështje, njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Athina. "Mendoj se edhe Qeveria greke gjithashtu e kupton se ky është një hap i mirë për politikën e jashtme greke në rajon, që të gjendet zgjidhje, për këtë çështje shumëvjeçare. Për këto arsye ekziston një moment pozitiv midis dy vendeve. Mendoj se qytetarët në të dy vendet mbase janë të përgatitur që të dëgjojnë zgjidhje të caktuara, që janë në interes të përbashkët, por gjithashtu ka kompromis të caktuar kjo të zgjidhet", tha Nimici. Ai gjithashtu vuri re se në rajon ekziston shqetësim rreth çështjeve të caktuara, siç janë refugjatët, terrorizmi apo jostabiliteti dhe se me udhëheqjen e komunitetit ndërkombëtar këto çështje duhet të zgjidhen.



KOSOVA DHE MAQEDONIA, VENDET MË FETARE NË EVROPË

Shkup, 15 janar - Një anketim i ri, i cili bazohet në tre sondazhet të WIN/Gallup International, publikuar në gazetën Telegraph të Britanisë së Madhe, tregon se ballkanasit janë më fetarë se homologët e tyre në Evropën Perëndimore. Anketimi, i cili ka analizuar tre sondazhe të marra gjatë disa viteve dhe i ka kthyer ato në një hartë të botës, sugjeron se feja mbetet një faktor më i fuqishëm në mendjet e njerëzve dhe në sho-

qëri, në të gjitha vendet ish-komuniste të rajonit të Ballkanit, me përjashtime të pjesshme të Bullgarisë dhe Shqipërisë. Kosova, Maqedonia dhe Rumania rezultojnë të jenë shoqëritë më fetare dhe të vetëdijshme për këtë në rajon dhe në Evropë; ku 88% e njerëzve në Maqedoni, 83% në Kosovë dhe 77% në Rumani e konsiderojnë veten besimtarë. Serbia, Kroacia, Mali i Zi dhe Greqia pasojnë me 70% deri 72% të popullatës së tyre

që e konsiderojnë veten si besimtarë. Bosnja vjen më pas me 65%. Bullgaria mbetet disi mbrapa, me vetëm 52% të popullatës atje që e sheh veten si besimtar. Shqipëria është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit me një sjellje të "stilit perëndimor" ndaj fesë - ku vetëm 39% e popullatës e konsideron veten fetar, e njëjta përqindje si Austria dhe Hungaria dhe pak më shumë se Spanja (37%). Në Evropën Perëndimore, Italia, kryeqendra e

Kishës Katolike është i vetmi vend ku shumica dërrmuese e popullatës e konsideron veten besimtarë - 74%. Në vende të tjera shifrat priren të jenë më të ulëta - 30% në Mbretërinë e Bashkuar, 26% në Holandë dhe 34% në Gjermani. Veriu i Evropës është veçanërisht jo-fetar. Vetëm 16% të estonezëve kanë ndjesi fetare, 19% e suedezëve dhe 21% e norvegjezëve. Panorama është më e përzier në Evropën Qendrore dhe varion nga

86% në Poloni në vetëm 23% në Republikën Çeke. Në vende të tjera të botës, në Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Azinë Juglindore vendet priren të jenë shumë fetare, shifra që variojnë përgjatë viteve. Azia është gjithashtu shtëpi e dy shoqërive më pak fetare në botë, Kinës dhe Japonisë, ku vetëm 7% dhe 13% e popullatës rrëfejnë se kanë ndjesi fetare. Sondazhi u prodhua për të shënuar Ditën Botërore të Fesë, 14 janarin. (BIRN)

VËREJTJET E PARA PËR PROPOZIM-LIGJIN E ARSIMIT TË LARTË

MASH-i E DO KONTROLLIN E PLOTË TË ARSIMIT TË LARTË

“Në një rën prej pikave për funksionim e tij, çështjet administrative teknike të Këshillit Nacional të Arsimit të Lartë thuhet se do ti kryejë administratat e MASH-it. E njëjta gjë do të vlejë edhe për Këshillin e Akreditimit të Këshillin e Evaulimit, që do të thotë se po vendoset një kontroll mbi këta institucione, të cilat duhet të jenë subjekte të pavarura nëse dëshirojmë të kryejnë punë të pavarur profesionalisht”, pohon Bashkim Ziberi, anëtarë i KAE-së. Shqetësuese, sipas tij, janë edhe kriteret e zgjedhjes së anëtarëve si dhe mos caktimi i rregullave të delegimit të tyre

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 15 janar - Propozim-ligji për Arsim të Lartë, në formë që është aktualisht - ka nevojë për intervenime të shumta, duke nisur nga mënyra se si e rregullon mënyrën e funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, zhvillimin e tyre, punën kërkimore, zgjedhjen e profesorëve dhe organet drejtuese, mekanizmat e kontrollit të cilësisë, e kështu me radhë. “E parë në përgjithësi, Propozim-ligji është kthim në Ligjin e 2008-ës”, shprehet profesori universitar Bashkim Ziberi, i cili është edhe anëtarë i Këshillit të Akreditimit dhe Evaulimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Maqedoni (KAE). Nisur nga ndryshimet e shumta që ka pësuar Ligji në të kaluarën e për çka është tepër konfuz, ishte koha e fundit që në Maqedoni të nxirret një Ligji i ri, gjithëpërfshirës dhe kërkues në cilësinë e arsimit të lartë. “Prandaj mendoj se paralelisht me këtë Ligj, të përgatitet edhe Ligji për Veprimtari Shkencore dhe Ligji për Inovacione, me qëllim që të jenë në harmoni njëri me tjetrin”, pohon ai, ndërsa ka vërejtje edhe për mënyrën se si është konceptuar administrimi i institucioneve të pavarura profesionale.

Sikurse pritej me Propozim-ligjin e arsimit të lartë, institucioni i KAE do të kthehet siç ka qenë deri 2015-ën, në Këshill të Akreditimit dhe Këshill të Evaulimit, ndërsa në mbikëqyrje të punës së këtyre dy institucioneve dhe gjithë sistemit të arsimit të lartë - do të krijohet një Këshill Nacional për Arsimin e Lartë (KNAL). Profesor Ziberi thotë se nuk ka asgjë të keqe nëse kjo shihet si plotësim i mekanizmave të kontrollit. Mirëpo, shqetësuese sipas tij, është varësia që do të kenë të tre këto institucione

nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në mbledhjen e 11 janarit kur KAE diskutoi tekstin e Propozim-ligjit, thotë është përsëritur ideja e themelimit të KNAL-së, por problemi qëndron te modeli i funksionimit. “Propozim-ligji realisht i jep kompetenca të zgjeruara këtij Këshilli, por duhet të bëhet kujdes te predispozitat e funksionimit të tij. Nuk do të ketë pavarësinë që do të duhej ta kishte, pra nuk është një subjekt juridik. Do të themelohet nga Parlamenti, do të ketë anëtarë të zgjedhur të tij, por nuk do të ketë një buxhet të vetin. Në një rën prej pikave për funksionim e tij e KNAL-së, thuhet se çështjet administrative teknike do ti kryejë administratat e MASH-it. E njëjta gjë do të vlejë edhe për KA-në dhe KE-në, që do të



Natyrish që ka edhe ndryshime pozitive në këtë Propozim-ligj, një prej të cilave është edhe ndarja e Rektoratit nga Senati. Pra, Rektori i një universiteti nuk mund të jetë edhe kryetari i Senatit, mund të merr pjesë në mbledhjet e Senatit, por jo edhe të ketë të drejtë vote. Me këtë, universitetet fitojnë një lloj pavarësie të munguar prej kohësh

thotë se po vendoset një kontroll mbi këta institucione, të cilat duhet të jenë të pavarura nëse dëshirojmë që të jenë të pavarura edhe profesionalisht”, pohon Ziberi. Jo më pak shqetësuese, sipas tij, janë kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të KNAL-së, për të cilët mjafton që të jenë vetëm profesorë ordinarë dhe nuk mbahet llogari as për performancën shkencore dhe as për përvojën ndërkombëtare. “Mendoj se është një kriter jashtëzakonisht i ulët, aq më tepër ku tani e një kohë të gjatë sistemi i arsimit të lartë ka dalë prej kontrollit dhe si rezultat i kësaj - është shumë e diskutueshme edhe mënyra e marrjes së gradave akademike. Jemi dëshmitarë të mosfunksionimit të sistemit të meritokracisë në këtë drejtim dhe, të vendosësh kriter zgjedhje të anëtarë të KNAL-së vetëm gardën ‘profesor ordinar’ - është gabim. Në këtë Këshill duhet të zgjidhën ‘më të mirët e më të mirëve’, sepse është fjala për një institucion kupolë të arsimit të lartë”, shpjegon ai.

Një e metë tjetër thotë se është mënyra e delegimit të anëtarëve. Në propozim-ligj thuhet se do të jenë gjashtë anëtarë, të cilit i propozon Konferenca Ndëruniversitare, mirëpo nuk saktësohet se nga cilat universitete. Në këtë Konferencë bëjnë pjesë anëtarë të rreth 20 universiteteve, ndërsa edhe më kontestuese për profesor Ziberin është kriteri i emërimit të anëtarëve për institucionin e KA-së dhe KE-së. “Kërkohet që anëtarët (nga 6 secila) të zgjidhen në bazë të numrit të studentëve që regjistrojnë studentët në vitin e parë akademik. Ky nuk është kriter që duhet vendosur për zgjedhjen e anëtarëve. Por thjeshtë, do ti bëjë universitetet të vrapojnë pas studentëve, në mënyrë që të mund të hyjnë në 6-shen e parë”, shprehet ai. Ideja të paktën në dukje e mbajtjes në kontroll politik të institucioneve që realisht duhet të jenë të pavarura, rrezikon që ti kthejë KA-në, KE-në dhe KNAL-në në “satelitë” të MASH-it, që në instancë të fundit - është institucion politik. Ziberi shpreh se këto vërejtje, të cilat i janë dërguar MASH-it edhe në formë të shkruar - do të merren parasysh nga Komisioni për hartimin e Propozim-ligjit dhe se të njëjtët do të inkuorohen në variantin final të Ligjit të arsimit të lartë, me qëllim që ligji i ri të reflektojë kujdesin e duhur për nivelin e cilësisë në pjesën që ka të bëjë me institucionet kupolë të cilësisë së arsimit.

Ka padyshim dhe shumë segmente të tjera, të cilat lënë hapësirë kontestimi dhe për të cilat duhen debate konstruktive. Natyrish që ka edhe ndryshime pozitive në këtë Propozim-ligj, një prej të cilave është edhe ndarja e Rektoratit nga Senati. Pra, Rektori i një universiteti nuk mund të jetë edhe kryetari i Senatit, mund të merr pjesë në mbledhjet e Senatit, por jo edhe të ketë të drejtë vote. Me këtë, universitetet fitojnë një lloj pavarësie të munguar prej kohësh. Por, jo pak vend për diskutim do të hap mënyra e zgjedhjes së Rektorit, si dhe kriteret që duhen përbushur për një karrierë të tillë, apo edhe “rregullat e reja” për organizimin e studimeve të ciklit të tretë.

KRONIKË

Vdes 62-vjeçari nga një plagë e marrë në kokë

Një shkupjan gjashtëdhjetë e dy vjeçar është gjetur i vdekur me plagë nga armë zjarri në kokë, kumtoi policia. “Në njësitin për informacione dhe komandë Shkup dje në ora 07:26, L.P. ka denoncuar se me plagë nga armë zjarri në kokë e ka gjetur gjyshin e tij Zh.M. (62) në shtëpinë e tij në rr. “Ivan Naumov Alabakot” në Shkup, qëndron në buletin e policisë. Mjeku i Urgjencës ka konstatuar vdekjen, ndërsa ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i MPB Shkup. Me urdhër të prokurorit publik, mbi trupin e të vdekurit do të kryhet autopsi.

Mbetje të një njeriu në fermën e derrave

Mbetje të një trupi njerëzor dje janë gjetur në atarin e fshatit Bërvenicë të Tetovës, kumtoi policia. “Dje në ora 13:20 në Qendrën për njoftim dhe komandë Tetovë është denoncuar se në atarin e fshatit Bërvenicë të Tetovës, gjegjësisht në fermën për derra janë gjetur mbetje të trupit njerëzor. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB Tetovë. Mbetjet janë marrë dhe i janë dërguar mjekut të Mjekësisë ligjore për procedurë të mëturjeshme”, qëndron në buletin e policisë. Policia ka siguruar edhe disa copë veshje dhe ka ndërmarrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohen tri vajza në lokalet e Tetovës

Në aksionin e policisë në një objekt hotelierik në Tetovë mbrëmë janë arrestuar tre persona femra, kumtoi MPB-ja. “Në periudhë prej orës 23:50 të datës 14.01.2018 deri në ora 00:35 të 15.01.2018, Sektori për krim tejkufitar, të huaj dhe riatdhesim, në bashkëveprim me efektivët e policisë nga stacioni policor Tetovë kanë kryer aksion kontrolli në një objekt hotelierik në Tetovë. Gjatë kontrollit, në objekt janë hasur tre persona femra, nga të cilat njëra ka qenë shtetase e Republikës së Maqedonisë, ndërsa dy D.S. (26) dhe N.D. (18) janë shtetase të Republikës së Shqipërisë, theksohet në buletin e policisë. Të gjithë tre personat janë arrestuar dhe mbajtur në stacionin e policisë Tetovë. Pas dokumentimit të plotë të rastit, kundër shtetaseve të huaja do të ngritet kallëzim penal për keqpërdorim të qëndrimit turistik.

Arrestohet polici “i rremë” nga Tetova

Një tetovar (40), i cili rrejshëm prezantohet si polic, mbrëmë u arrestua në rrugën magjistrare Gostivar - Kërçovë, thuhet në buletin policor. “Mbrëmë në ora 20:10 në rrugën magjistrare Gostivar - Kërçovë është vërejtur një automobil i parkuar ‘mazda’ me targa të Shkupit, ku ka qenë personi S.M. (40) nga Tetova. Nga ana e nëpunësve policorë është bërë ekspertizë e automjetit dhe personit, me ç’rast janë gjetur një dokument zyrtar identifikimi me emblemë të MPB-së së Republikës së Maqedonisë me fotografi të S.M., një jelek fosfori, notes i vogël me fletë-gjoba dhe ozoner me emblemën ‘policia’, informojnë nga policia. Për shkak të prezantimit të rrejshëm, sipas nenit 391 nga Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, S.M. i cili u evidentua si kryerës i veprave penale “mashttrim”, është privuar nga liria dhe mbajtur në Stacionin policor Gostivar për procedurë të mëtejshme. (U.H)

KRONIKË

Rrahjet 23 vjeçari nga Reçica

Të dielën mbrëma pas mesnate, në Sektorin për punë të Brendshme në Tetovë, nga një i punësuar në Spitalin Klinik të Tetovës është denoncuar se në spital është sjellë 23-vjeçari me iniciale B.B nga Reçica e Madhe, me lëndime të marra në kokë dhe trup. Ai ka deklaruar se rreth orës 22.20 minuta në rrugën e "Ilindenit" është takuar me një person nga Tetova me të cilin ka qenë edhe një person tjetër me një veturë të tipit "BMW", me regjistrim të panjohur të veturës. Në një moment personi me të cilin është takuar me një objekt hekuri e ka goditur në trup dhe në kokë. Pasi B.B ka rënë në tokë dy personat kanë vazhduar që ta godasin me shkelma në trup, pas një kohe të shkurtër me anë të veturës janë larguar në drejtim të panjohur. B.B i është ofruar ndihma mjekësore dhe është mbajtur në spital për shërim të mëtutjeshëm. Sektori për punë të Brendshme në Tetovë po ndërmer masa për gjetjen e autorëve të kësaj rrahje fizike si dhe zbardhjen e plotë të rastit.

Vjedhje e rëndë në një banesë në Shkup

Një autor i panjohur në periudhën nga ora 04:00 deri në orën 17:00 të ditës së diel, ka kryer vjedhje të rëndë në banesën e K.H. (44) në rr. "Kozle" në Shkup. K.H. mbrëmë e ka paraqitur vjedhjen në polici. Autori i panjohur me mjet të rëndë e ka hapur derën e ballkonit, ka hyrë në banesë dhe ka marrë një orë dore për meshkuj të markës "Brejting" në vlerë prej 1.200 euro, sasi më të madhe të stolive të arit, një armë dhe plumba të cilat i dëmtuari i ka poseduar me leje, informon MPB-ja. Pas vjedhjes së kryer, autori ka ikur në drejtim të panjohur. Në atë mënyrë, ai ka marrë dobi të paligjshme pronësore prej rreth 1.000.000 denarë, ndërsa ka shkaktuar dëm material prej rreth 5.000 denarëve. Merren masa për gjetjen e autorit dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

Shkup, një i vdekur dhe mbi 20 të lënduar në 25 aksidente

Një person e ka humbur jetën në një prej gjithsej 25 aksidenteve që kanë ndodhur gjatë fundjavës në rajonin e SPB Shkup. Në aksident, një person ka marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa më lehtë të lënduar janë 21 persona në nëntë aksidente. Në 15 aksidente është shkaktuar dëm material. Nga MPB-ja informojnë se policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundërvajtjeve. Njëqind e gjashtëdhjetë shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, 11 shoferë kanë kaluar në dritën e kuqe të semaforit, dy shoferë nuk iu kanë dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve, pesë shoferë janë dënuar për rreshtim të papërshtatshëm dhe një shofer për tejkalim të papërshtatshëm. Nga komunikacioni janë përjashtuar tetë shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 35 shoferë para se të marrin të drejtën për të drejtuar automjet motorik dhe katër shoferë fillistarë, si dhe një automjet me probleme teknike dhe 25 automjete pa regjistrim. Është sanksionuar një këmbësor i cili nuk ka kaluar në vendkalimin për këmbësorë. Janë hasur edhe 145 automjete të parkuara në mënyrë të papërshtatshme. Me ndihmën e automjetit special karrotrec, janë larguar 141 automjete. (O.XH)

NDRYSHIME NË LIGJIN PËR TREGJET E GJELBËRTA



NJË LIGJ QË MBRON TEZGAXHINJTË

Implikimet, të cilët burojnë nga Regjistri Qendror, e kanë shtyrë Odën e Tregtarëve të Maqedonisë të kërkojë thjeshtëzimin e procedurës për regjistrimin apo fshirje të veprimtarisë së caktuar që e kryen një tregtar. Kapaciteti i një tregtari në Bit Pazar apo në ndonjërin prej tregjeve tjera, siç tha Dolek, është tejet i vogël për t'ju kundërvër kushteve që i kërkojnë nga Regjistri Qendror

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 15 janar - Regjistrimi i firmave të tregtarëve që posedojnë tezgja në ndonjërin prej tregjeve të gjelbërta në Maqedoni nuk do të bëhet më përmes regjistrimit të kompanive të tyre në Regjistrin Qendror. Kjo mënyrë e re e funksionimit të tregjeve të gjelbërta është paraparë me ndryshimet e fundit të Ligjit për tregjet e gjelbërta në vendin tonë. Kryetari i Odës së Tregtarëve të Maqedonisë, Ekrem Dolek, gjatë takimit me gazetarë, njoftoi se pas hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave, tregtarët që veprimtarinë e tyre e kanë të shtrirë në tregjet e gjelbërta, do të mjaftojnë të pajisen vetëm me një leje (licencë) pune që do ta ndajnë ata.

Implikimet, të cilët burojnë nga Regjistri Qendror, e kanë shtyrë Odën e Tregtarëve të Maqedonisë të kërkojë thjeshtëzimin e procedurës për regjistrimin apo fshirje të veprimtarisë së caktuar që e kryen një tregtar. Kapaciteti i një tregtari në Bit Pazar apo në ndonjërin prej tregjeve tjera, siç tha Dolek, është tejet i vogël për t'ju kundërvër kushteve që i kërkojnë nga Regjistri Qendror.

"Me marrjen e Licencës nga Oda e Tregtarëve, tezgaxhinjtë pa problem do të mund ta zhvillojnë biznesin e tyre brenda tregjeve të gjelbërta. Kjo leje e punës do të jetë me afat të kufizuar prej një viti. Shkaku se pse e kemi caktuar për këtë afat kohor është se shumë persona brenda vi-

tit e provojnë fatin e tyre në tregjet e gjelbërta. Një pjesë e tyre arrijnë të mbijetojnë dhe një pjesë tjetër dorëzohen dhe largohen nga pazaret. Lartësia e çmimit të kësaj licencë, në mënyrë shtesë do të miratohet nga Ministria e Ekonomisë dhe nga ne si Odë. Kuptohet se një përqindje e vogël nga marrja e këtyre lejeve të punës do të shpërndahet dhe në buxhetin e shtetit", tha Dolek. Mes tjerash, ai shtoi se fiskalizimi i shumëpërfolur të tregjeve të gjelbërta në Maqedoni, nuk do të ndodhë deri sa shteti nuk bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Sigurimi shëndetësor dhe pensional, po ashtu, siç njoftoi Dolek, me ndryshimet e fundit ligjore do të bëhet sikurse me tarifën e bujqve individual në vendin tonë. Kjo tarifë, sipas tij, do të jetë më e lehtë dhe e përballeshme për shumicën e tregtarëve që punojnë në tregjet tona. Tatimi personal ndonëse prej vitit 2011 e këndej paguhet nga tezgaxhinjtë në mënyrë paushalle, kjo mënyrë e pagesës së tatimit personal tashmë është përfshirë në Ligjin për tregjet e gjelbërta.

"Qëllimi se pse kemi insistuar në një taksë të tillë ka qenë mënjanimi i ngarkesave burokratike ndaj tezgaxhinjve, mos angazhimi i kontabilistëve, përgatitja e raporteve të të hyrave dhe daljeve vjetore, faktura e ndryshme e kështu me radhë. Profesionit i një tezgaxhiu është tepër kompleks dhe shumë është vështirë të mbahen shënime se mall ka shitur apo ka blerë, në kohë kur kushtet klimatike ndry-

shojnë nga dita në ditë dhe malli shpesh herë prishet dhe hidhet", theksoi Dolek. Me ndryshimet e Ligjit për tregjet e gjelbërta, përveç që kanë përfituar tregtarët që punojnë në këto pazare, benefitet kanë shkuar edhe në konto të shtetit. Statistika e Odës së Tregtarëve të Maqedonisë thotë se në vend funksionojnë rreth 20 mijë tezgaxhinj, të cilët me marrjen e licencave për punë, ato me automatizëm do të përjashtohen nga lista e personave të papunë dhe në këtë mënyrë - ata do të figurojnë si persona që posedojnë një biznes të vogël. Ndryshe, tregtarët që funksionojnë në tregjet e gjelbërta dhe paralelisht pranojnë ndihmë sociale, me këto ndryshime atyre - kjo ndihmë do t'ju ndërpritet. Problem shtesë i tezgaxhinjve, me të cilët këto tregtarë ballafaqohen vite të tëra, janë shitësit e egër. Me vetë ndarje e licencave për punë, sipas Dolek, shitësit e egër do të përballen me politikën ndëshkuese të cilën e parasheh ligji. Duke treguar nevojën e madhe të miratimit të këtij Ligji, nga Oda e Tregtarëve kanë theksuar se pazaxhinjve u është korrigjuar një e padrejtë, të cilët e kanë vuajtur për plot 25 vite nënçmim, maltretim e diskriminim. Për miratimin e Ligjit të shumëpritur, nga kjo Odë theksuan se më meritë janë deputeti, tashmë kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, deputeti aktual i LSDM-së, Goran Milevski dhe dy deputetët e BDI-së, Artan Grubi e Ejup Alimi.

Sistemimi i kuadrove në kopshte, kompetencë e komunave

Shkup, 15 janar - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale vetëm jep pajtueshmëri për punësim, ndërkaq punësimi dhe sistemimi i kuadrit është në kompetenca të komunave, përkatësisht të drejtorëve të institucioneve për mbrojtje të fëmijëve, theksojnë nga MPPS duke reaguar ndaj konferencës për shtyp të Ambasadës së parë të fëmijëve në botë "Megjashi" dhe prindërve të fëmijëve nga kopshti "Koço Racin" për ndërrimin e një edukatores. Ndërrimi, theksuan ata, i ka shkëlur të

drejtat e fëmijëve dhe kërkuan reagim nga institucionet. "Ministria mund të reagojë vetëm në rast kur shkelen dispozitat nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve, ku në mënyrë decide janë cekur rastet kur është kryer shkelje në pjesën e mbrojtjes së fëmijëve të përkujdesur në institucionet për fëmijë", thuhet në reagimin nga MPPS. Nga atje shtojnë se Ministria mbetet tërësisht e përkushtuar në tejkalimin e problemeve të trashëguara në institucionet publike për fëmijë - kopshtet e fëmijëve

dhe se janë siguruar kushte për funksionim të papenguar dhe për kujdes të papenguar për fëmijët shfrytëzues. "Për atë qëllim, janë shtyrë marrëveshjet për punësim në kohë të pacaktuar. Ndërkohë, Ministria po bën analizë të hollësishme të çdo institucioni në veçanti, pas çka do të pasojë zgjidhja e përhershme e problemeve kadrovike të cilat në kopshte i krijoi Qeveria paraprake, duke i mbajtur në paqartësi të përhershme edukatorët, prindërit dhe fëmijët", thuhet në reagim.

Me ndryshimet ligjore do të shënohet çdo veturë në varësi prej emetimit të gazrave ndotës. Në këtë mënyrë do të seleksionohen veturat që do të largohen nga komunikacioni gjatë ndotjes së madhe të ajrit

NGJITËSE EKOLOGJIKE PËR VETURAT

NDOTËSIT DO TË LARGOHEN NGA TRAFIKU



Nga gati 390 mijë vetura që qarkullojnë në rrugët e Maqedonisë, më shumë se gjysma janë më të vjetra se 15 vjet. Sipas të dhënave të Entit të Statistikës në Maqedoni deri në fund të vitit 2015 janë të regjistruara 383.833 vetura pasagjerësh, ndërsa 261.470 vjetra janë më të vjetra se 16 vjet apo janë të prodhuara para vitit 2002

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 janar - Nga fillimi i verës pritet të hyjnë në fuqi ndryshimet e reja ligjore me të cilat të gjitha veturat do të fitojnë ngjitëse ekologjike me ngjyra të ndryshme që do të tregojnë se cili automobil sa ndot ambientin. Kjo nënkupton se me ndryshimet ligjore do të shënohet çdo veturë në varësi prej emetimit të gazrave ndotës. Në këtë mënyrë do të seleksionohen veturat që do të largohen nga komunikacioni gjatë ndotjes së madhe të ajrit. Këtë e parashikojnë ndryshimet e Ligjit për vetura që për momentin i përgatit Ministria e Ekonomisë. Aktualisht po punohet në propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për vetura, ose në intervenimet ligjore që duhet të inkuorohen në Ligjin për vetura dhe aktet nënligjore të Ligjit për vetura thonë nga Ministria e Ekonomisë. Ligji duhet të jetë gati deri në fund të muajit shkurt, kur edhe do të dorëzohet në Qeveri dhe Kuvend. Pri-

tet që ndryshimet ligjore të miratohen dhe hyjnë në fuqi deri në fundin e muajit qershor. Një pjesë e organizatave joqeveritare ekologjike në Maqedoni vlerësojnë se shënimi i veturave sipas asaj se sa ndotin ajrin dhe largimi nga qarkullimi kur ndotja është alarmante, është një masë për tu përshëndetur, por megjithatë duhet të përcillet edhe me masa të tjera lehtësuese.

"Problemi i ndotjes së ajrit në Maqedoni është shumëdimensional, dhe radikal andaj edhe kërkohet masa radikale që të zgjidhet. Në zbatimin e masave të ndryshme që përfshijnë sektorë të ndryshëm, dikujt edhe do ti priset edhe komoditeti, por të mos harrojmë se shëndeti i qytetarëve të moshave të ndryshme thjesht nuk ka çmim",

thotë Arijanit Xhaferi, kryetar i organizatës joqeveritare, EkoGerilla nga Tetova. Sipas tij, EkoGerilla ka qenë e para në Maqedoni që ka propozuar kategorizimin e veturave në varësi prej nivelit të ndotjes. Kjo masë në praktikë do të sjellë vetëm dobi për qytetarët, por kërkon që gjatë zbatimit të saj edhe lehtësime të caktuara për vozitësit.

"Gjatë zbatimit të kategorizimit të veturave nevojitet që të ketë një kontroll më rigoroz të punës edhe të kompanive që kryejnë kontrollin teknik. Ato gjatë kategorizimit të veturave sipas ndotjes nuk duhet të bazohen në librezën e veturës, por nevojitet të përcaktojnë gjendjen faktike të kategorisë së ndryshme eko. E dyta, Qeveria duhet të mendojë edhe për mbë-

shtetjen e kredive të buta me kamatë prej 1 deri 2 për qind për 5 deri 10 vjet që të ndryshohet parku vozitës në vend. Duhet të mendohet edhe për mbështetjen e vendosjes së filtrave në veturat e vjetra si dhe për subvencionimin e vendosjes së impianteve për përdorimin e gazit për ngasjen e veturës në vend të dizelit" shton më tej Xhaferi. Ai shton më tej se edhe masat për rritjen e akcizës prej 3 denarë nuk do të dekurajojnë vozitësit të ngasin veturat me dizel për shkak se ai që është i gatshëm të paguajë 50 denarë do të paguajë edhe 53 denarë për një litër të karburantit. Edhe masat që propozohen në opinion siç janë vozitja e veturave çift-tek nuk janë zgjidhje e problemit me ndotjen që shkaktohet nga veturat.

Në ndërkohë, nga gati 390 mijë vetura që qarkullojnë në rrugët e Maqedonisë, më shumë se gjysma janë më të vjetra se 15 vjet. Sipas të dhënave të Entit të Statistikës në Maqedoni deri në fund të vitit 2015 janë të regjistruara 383.833 vetura pasagjerësh, ndërsa 261.470 vjetra janë më të vjetra se 16 vjet apo janë të prodhuara para vitit 2002. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e veturave në vend, ose 209.122 kanë ngasje me benzin, ndërsa 163.038 kanë ngasje me motor dizel. Impiant për gaz kanë të instaluar 10.896 vetura, ndërsa janë regjistruar edhe 33 vetura hibride dhe elektrike.

Ligji për shërbime audiovizuale nuk do të tërhiqet

Shkup, 15 janar - Ligji për shërbime audio dhe audiovizualen nuk do të tërhiqet, por mbetemi të hapur për diskutim, deklaroi të hënën ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski lidhur me vërejtjet nga disa shoqata të caktuara se ligji është antikushitetues dhe diskriminues. "Do të doja të di përse këto shoqata në shumë debate publike që i patëm nuk e thanë këtë qëndrim, por e thonë përmes briefingjeve në opinion. Ligji nuk do të tërhiqet sepse në pajtim me informatat që i kam për një takim në Odën ekonomike të Maqedonisë, pjesëmarrësit nuk e ndajnë këtë mendim. Megjithatë mbetemi të hapur për diskutime dhe debat publik, e jo prapa dyerve të mbyllura, ta zgjidhim këtë problem dhe absolutisht jam i sigurt se do të gjejmë zgjidhje", tha Mançevski, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve. Kohë më parë, zëdhënësi qeveritar, Mile Boshnjakovski deklaroi se Propozim ligji për shërbime audio dhe audiovizuale para se të hyjë në procedurë qeveritare do të shkojë edhe për një shqyrtim në Komisionin evropian, me kërkesë të tij.

ODA EKONOMIKE E PAKËNAQUR ME KOMUNIKIMIN INSTITUCIONAL

Shteti nuk mërzhitet shumë për kërkesat ekonomike

Shkup, 15 janar - Bashkëpunim më efikas dhe komunikim më të mirë me dhe mes ministrive, si dhe institucioneve tjera kompetente për implementim më të shpejtë të nismave nga bashkësia e biznesit, kërkohet Oda Ekonomike e Maqedonisë. Oda, siç është thënë të hënën në konferencën për shtyp, vlerëson se Plani qeveritar për rritje ekonomike në përgjithësi i përmban masat e propozuara nga kompanitë, por është i domosdoshëm veprimi më i shpejtë dhe përkthimi i tyre në vendime konkrete ligjore. "Plani i Qeverisë për rritje ekonomike i përmban kërkesat e bashkësisë së biznesit. Gjithçka që është pozitive duhet të respektohet dhe zhvillohet. Por, puna jonë është që të sugjerojmë me kohë dhe për këtë themi se është i domosdoshëm veprimi më i shpejtë i ministrive kompetente për miratimin e vendimeve ligjore në bazë të nismave të parashtruara nga kompanitë", theksoi Elena Milevska Shtërbevaska, drejtore operative e Odës Ekonomike të Maqedonisë. Milevska Shtërbevaska informoi se nga qershori deri në fund të vitit 2017 Oda ka parashtruar 19 nisma në Qeveri dhe asnjë prej tyre nuk është refuzuar, por realizimi, potencoi duhet të jetë më i shpejtë. Sipas Odës, ekziston vullnet i fuqishëm nga ana e Qeverisë për bashkëpunim me sektorin e biznesit dhe partneriteti tashmë është vendosur, por



megjithatë nevojitet komunikimi më i mirë dhe më efikas. "Pa procedura të shpejta dhe efikase administrative, pa ulje të burokratizimit dhe pa administratë profesionale nuk mund të shkojmë përpara dhe të presim realizim të shpejtë të nismave tona që janë në interes të avancimit të klimës afariste në shtet", deklaroi Milevska-Shtërbevaska. Në mesin e kërkesave të Odës Ekonomike është edhe ajo për pezullimin e kufizimit kohor të shitjes së pijeve alkoolike dhe uljen e çmimit të licencave për këtë dedikim. Gjithashtu, presin ndryshime të caktuara tatimore, si dhe ndryshime të ligjit për veprimtari notere, për përmbarrim, për ndërtim dhe një varg ligjesh tjera që duhet të lehtësojnë punën e ndërmarrjeve. Deri tani, nuk duan të ko-

mentojnë lëshimin e eurobondit me vlerë prej gjysmë miliardë euro. Por, paralajmërojnë se do të ndjekim me vëmendje se si shpenzohen rreth 400 milionë euro që janë parashikuar për investime kapitale në vitin 2018. "Çdo tre muaj, publikisht dhe në mënyrë transparente do të kërkojmë që të bëhet një prerje e aktiviteteve të projektuar përballë atyre të realizuara në pjesën e investimeve kapitale dhe të bartë përgjegjësi nëse nuk realizohen", drejtoresha operative e Odës Ekonomike të Maqedonisë. Në fokusin e interesave të Odës Ekonomike në periudhën e ardhshme do të jetë edhe realizimi i Planit për rritje ekonomike, i cili parashikon mbështetje të drejtpërdrejtë për ekonominë prej 50 milionë eurove. (Z.V)

TETOVË, REFUZOHEN MBI 2000 KËRKESA PËR LEGALIZIM

LEGALIZOHEN MBI 4000 OBJEKTE TË EGRA

Komuna e Tetovës, në nivel të shtetit para sjelljes së Ligjit për legalizim të objekteve pa leje ndërtimi, ka qenë në krye të listës. Sipas tyre, prandaj edhe është pritur që të ketë numër enorm të kërkesave



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 15 janar - Mbi 4000 objekte të palegalizuara deri më tani janë legalizuar në territorin e Komunës së Tetovës, që kur ky proces filloi para shtatë vitesh. Nga Komuna e Tetovës njoftuan se ka ende shumë qytetarë të cilët nuk e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë për legalizim, ndërsa kjo vërehet se çdo ditë ka qytetarë që parashtrajnë kërkesa. "Deri më tani janë përfunduar afër 4100 legalizime në territorin e Komunës së Tetovës, ndërsa qytetarët kanë kërkuar më së shumti legalizimin e objekteve për banim, më pas

janë shtëpitë apo objekte ndihmëse", thotë Armend Fazliu, zëdhënësi i Komunës së Tetovës. Komuna e Tetovës, në nivel të shtetit para sjelljes së Ligjit për legalizim të objekteve pa leje ndërtimi, ka qenë në krye të listës. Sipas tyre, prandaj edhe është pritur që të ketë numër enorm të kërkesave. Por ky proces ndonëse për ata qytetarë që kanë ndërtuar është i dobishëm, nga ana tjetër - për zhvillimin e qytetit ky proces është i dëmshëm. "Unë them se kjo është një thikë me dy

teha, në njërin anë qytetarët që kanë ndërtuar shtëpi dhe duan që ti regjistrojnë në Kadastër dhe të hynë në sistemin e tatimit e tjera, në anën tjetër planifikimin e dëmton shumë për shkak se rrugë të pahapura që janë të planifikuara deri më tani, ndoshta nuk do të mund të hapen për shkak se ndryshimet e fundit të Ligjit na detyrojnë neve që të legalizojmë objekte që kapin rrugë, infrastrukturë rrugore që ka qenë e planifikuar, por nuk është realizuar deri më sot.

Këto lëndë i kalojmë nëpërmjet Këshillit ku merret një vendim kolektiv konform Ligjit", theksojnë nga Komuna e Tetovës. Sipas tyre, Ligji është i dëmshëm sa i përket zhvillimit të qytetit. "Njëra palë shpërblehet mirë - ata që legalizojnë objektet e tyre, ndërsa pala tjetër - ne që duam të vendosim një rend e që duam të kemi një qytet të mirë organizuar - na prish shumë punë, por nuk kemi se çfarë të bëjmë. Jemi të obliguar të respektojmë ligjin ashtu si respektohet në të

gjithë shtetin", deklaroi Fazliu. Në ndërkohë, në procedurë të legalizimit janë edhe rreth 2400 objekte në territorin e Komunës së Tetovës. "Ka kërkesa që janë refuzuar për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit të kërkuar dhe ato janë të mbyllura në bazë të Ligjit, ndërsa numri i tyre është diku afër 2100-2400 kërkesa. Nga 2011 që është edhe afati i parë i parashtrimit të kërkesave për legalizim të objekteve, kemi të bëjmë me shumë kërkesa pa leje, këtë e zbuluam më vonë kur njerëzit filluan të vijnë të kërkojnë ndryshim të parashtruesit, gjë të cilën ne e kemi realizuar konform ligjit. Tek ato raste ku ka pasur kontratë shit-blerjeje në ndërkohë mes palëve, ose ka pasur ndonjë vendim për trashëgimi tek të afërmit e familjes me deklaratë të vërtetuar te noteri se kjo është e saktë ato lëndë janë procesuar, të tjerët që kanë pasur kërkesa për ndryshim të parashtruesit janë refuzuar", thotë Fazliu. Qyteti i Tetovës pas viteve të 90-ta u përfshi nga ndërtimet e shumta. Koncetrimi më i madh ishte në ndërtimin e ndërtesave shumëkatëshe sidomos në pjesën në dalje të Tetovës për në Gostivar.

Teatri i Tetovës dhe Teatri Shqiptar i Shkupit që i kanë mbyllur projektet e vitit të kaluar janë duke u përgatitur për shfaqjet e para të 2018. Në skenat shqiptare rikthehet Dino Mustafiq, Ilir Bokshi..., ndërsa Shekspiri është një prej dramaturgëve të preferuar që nuk do të mungojë edhe këtë vit.

Koha Evis HALILI

Shkup, 15 janar - Autorë të huaj dhe emra të spikatur të dramaturgjisë bashkëkohore do të jenë pjesë e repertorit të teatrore shqiptare gjatë këtij viti. Në skenat shqiptare rikthehet Dino Mustafiq, Ilir Bokshi..., ndërsa Shekspiri është një prej dramaturgëve të preferuar që nuk do të mungojë edhe këtë vit. Teatri i Tetovës dhe Teatri Shqiptar i Shkupit që i kanë mbyllur projektet e vitit të kaluar janë duke u përgatitur për shfaqjet e para të 2018. Në Teatrin e Tetovës viti nis me Shekspirin, shfaqje kjo që do të realizohet nga regjisori Sulejman

REPERTORI 2018 NË TEATROT SHQIPTARE

NJË VIT NDRYSHE NË SKENAT SHQIPTARE



Rushiti dhe provat nisin të hënën. Në repertorin e këtij viti Teatri i Tetovës ka planifikuar gjithsej pesë shfaqje në gjuhën shqipe dhe dy në maqedonisht, ndryshe nga viti i kaluar kur u realizuan vetëm dy projekte, një në shqip dhe maqedonisht. Drejtoresha Blerta Mamudi thotë se javën e ardhshme nisin provat për projektin e parë të këtij viti, premiera e të cilit pritet të shfaqet në muajin mars.

"Pavarësisht se ende nuk është miratuar programi i këtij viti nga Ministria e Kulturës ne jemi gati për të filluar me provat për shfaqjen e parë për këtë vit. Dominojnë autorë të huaj dhe regjisorë nga vendi dhe Kosova. Për momentin Teatri i ka mbyllur edhe problemet

me llogaritë e papaguara dhe funksionojmë normalisht. Në programin e këtij viti po ashtu parashikohet edhe realizimi i Festivalit të Teatrot", thotë Mamudi.

Ndërsa për Teatrin Shqiptar të Shkupit repertori i këtij viti premtion të jetë spektakolare. Jo vetëm për shkak të shfaqjeve të përzgjedhura dhe emrave të njohur që do të realizojnë projektet, por edhe për hapjen e teatrit dhe përfundimin e punimeve që do të shoqërohen edhe me një logo të dizajnuar apostafat për fillimin e ri. Janë gjithsej tre projekte që do të sjellin në skenë aktorë dhe regjisorë të njohur, si Refet Abazi, Dino Mustafiq, Kushtrim Bekteshi e Ilir Bokshi. Përveç shfa-

qjes "Vdekja e Dantonit" regjisorit Mustafiq do t'i besohet edhe kolazhi nga shfaqje të zgjedhura që do të realizohet me rastin e inaugurimit të ndërtesës së rikonstruktuar të teatrit, që besohet në muajt e fundit të këtij viti. Po ashtu Teatri Shqiptar do të jetë pjesë e një megaprojekti që financohet nga Bashkimi Evropian për realizimin e një shfaqje ku marrin pjesë pesë teatro nga rajoni.

Ndërsa në sektorin e Dramës Shqipe në Kumanovë të martën jepet premiera e fundit për vitin 2017. Në repertorin e këtij viti Drama Shqipe ka aplikuar me gjithsej katër projekte, një prej të cilave është shfaqje për fëmijë, ndërsa tre të tjerat janë të zhanreve të

ndryshme.

Edhe pse nga Ministria e Kulturës ende nuk është miratuar programi vjetor për çdo institucion, në teatro ka filluar puna për realizimin e projekteve të reja. Se cilat projekte dhe sa në total do të realizohen për çdo teatër do të shihet në fund të këtij muajin, kur shpallen edhe rezultatet e konkursit vjetor. Përveç këtyre teatrore edhe në qytete të tjera, si Dibër, Strugë, Shkup e Gostivar do të realizohen edhe projekte alternative. Festivali i Teatrotve Mbarëshqiptare si edhe Festivali i Kukullave në Dibër, në Gostivar Festivali i Teatrit Otello, K'tu fest në Strugë, Skupi Fest në Shkup, Festivali i Teatrotve në Tetovë, e të tjera.

Çmimi i mosnështrimit

Nga
Zeqirija IBRAHIMI



Derisa disa aktivistë e vajtojnë, disa aktivistë na shajnë të gjithëve dhe disa të tjerë na lusin që të bëhemi bashkë, si në ditët tona më të mira, besoj të gjithë këta me qëllimin më të mirë, duke më ardhur keq për secilin prej tyre, madje edhe për ata që më shajnë dhe që nuk ua kthej mesazhet që mos ta fëlliqin më shumë tastierën, por edhe duke e pasur parasysh kërkesën e opinionit të gjerë për t'u njohur nga dora e parë, vendosa më mirë ta shpjegoj vet se ç'po ngjet këto ditë me Besën tonë.

Kur erdhëm në skenë me Lëvizjen BESA, plot na paragjykuan "se janë si gjithë të tjerët", plot të tjerë na përcmuan "se janë fëmijë të lazdruar që duan pushtet", shumë të tjerë as që na përmendën diku dhe pati pak të tillë që na admiruan për guximin që të paraqitemi në skenë pikërisht kur partia shqiptare e asaj kohe sapo kishte prekur plafonin historik të votave që kishte marrë ndonjë parti shqiptare ndonjëherë. Sidoqoftë, me modestinë e takatit tonë, ne erdhëm duke u forcuar gjithnjë dhe duke u bërë zëri i vërtetë i shqiptarit të trevave autoktone në Maqedoni. Në të vërtetë, atë e kishim synuar krejt në fillim të vitit 2014, kur me mikun tim Afrim Gashi (dhe shokë të tjerë që pastaj erdhën në Besë pikërisht për shkak të idesë) e kishim dizajnuar Besën. Mendimi i jonë ishte se shqiptarëve të trevës së Maqedonisë u duhej një subjekt politik që do të ishte komplementar me shqiptarin e rëndomtë të këtij shteti. Dhe, si një e djathtë që e kishim menduar, thoshim se organizata politike nuk duhet ta ketë synim të prodhojë a të shpikë shqiptar të ri, shqiptar të shfytëruar (siç kishte synuar gjysmëshkulli e majta titiste dhe enveriste), por ajo duhej të ishte reflektim i asaj që është shqiptari i rëndomtë i kësaj treve, duke e marrë parasysh historinë e tij, kulturën e tij, arsimin e tij, gjendjen sociale, identitetin religjioz etj. Meqë në fillimet e themelimit të Lëvizjes raporti i ndërsjellë karshi parimeve ishte metafizik dhe ne besonim në parimet e politikëbërjes sonë, jorastësisht e quajtmë atë BESA. Ajo do të ishte Autentike, sepse ishte subjekt i parë i shqiptarëve në Maqedoni që ishte autentik në artikullimin politik, sepse tha se qenia e shpreh lirinë jo duke iu përshtatur rrethanave, por duke ia për-

shtatur rrethanat vetvetes; Autoktone, sepse ndërtohej mbi premisat e vlerave autoktone shqiptare në Maqedoni; dhe Autonome, sepse nuk ishte derivat i asnjë partie shqiptare të mëparshme në Maqedoni ose Kosovë e Shqipëri. Besa mëtonte të ishte sinonim i nacionalizmit të ri të shqiptarëve në Maqedoni, që nënkuptonte se edhe shqiptarët e këtij vendi ta kenë versionin e tyre të nacionalizmit. Për hesapin e politikës së brendshme në Maqedoni, Besa ishte partia e parë në historinë e politikëbërjes në Maqedonisë (nëse është ndonjë satisfaksion kjo që ishte e para) që tha se Maqedonia ishte një shtet i kurdisur keq, që ishte ndërtuar mbi definicione të gabuara dhe se duhej një ridefinim i saj, duke krijuar kohezion ndërmjet shoqërisë shumëmetrike dhe shtetit monoetnik. Kjo nënkuptonte që shoqëria dhe shteti duhej të bëheshin komplementarë mes vete. Menduam se e kishim gjetur formulën që na bënte komb të suksesshëm në Maqedoni, që na hiqte nga nacional-romantizmat e këngëve folklorike, por edhe që mundësonte një shtet të të bara-

bartëve konform trendeve euro-integruese. Mbi këto premisa e zhvilluam edhe aktivitetin opozitar. Shumë aktivitete, konferenca e debate, e veçmas dy protestat e organizuara nga Besa, e para më 13 qershor 2015 dhe e dyta më 9 maj 2016, që ishin dy protestat mbase më madhështore, më masovike dhe më mirë të organizuara kurdoherë të shqiptarët e Maqedonisë, ishin shenjë se më në fund po vinte në skenë një artikullim i drejtë dhe i saktë politik i shqiptarëve në Maqedoni. Por, ndonëse ky ishte lajm i mirë për neve, për të tjerët ishte shqetësim.

SHPIFJET


Meqë gjatë vitit 2015 në Maqedoni kishim krizë politike në plotkuptimin e fjalës, e cila në mënyrë më të zbehta zgjati edhe gjatë 2016-tës, zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2016 do të ishin një portë për një fazë tjetër të jetës politiko-shoqërore të Maqedonisë. Në ato zgjedhje Besa mori vota sa për shtatë deputetë, por për shkak të disa manipulimeve të bëra nga KSHZ-ja, arriti të regjistrojë vetëm 5 depu-

Ideatorët dhe idealistët e Besës do ta tejkalojnë edhe këtë grip, duke mos u nënshtruar as kësaj radhe, ani se disa sosh nuk kanë mundur ta durojnë presionin. Ne do të vazhdojmë t'i shërbejnë idesë së Besës të bindur se kjo ide do të ngadhënjejë një ditë. Në maratonë ka plot garues që nuk arrijnë ta përfundojnë garën dhe dorëzohen...



tetë. Megjithatë, edhe ata 5 deputetë ishin dëshmi se ideja e Besës ishte kapur nga elektorati dhe se po përtepej mirë për ta ndërtuar një frymë të re të skenës politike në Maqedoni. Testi i parë ishte kaluar, por testi i dytë ishte më i rëndë - formimi i qeverisë. Kur e mori mandatin Gruevski, Besës i erdhi selami për të bashkëqeverisur me të, madje edhe pa BDI-në, por përgjigja e saj ishte troç: "nuk pranojmë të ulemi me politikanë të inkrimnuar". Dhe, ndonëse Besa pati pastaj rol konstruktiv në ndërtimin e qeverisë së re, duke qëndruar e paepur përpara presionit të regjimit të atëhershëm VMRO-BDI (atëbotë BESA akuzohej si parti e afërt me LSDM-në, si soroside etj.), me çka iu kishte gjetur si partner i padyshimtë LSDM-së, pas zgjedhjeve element i patjetërsueshëm i formimit të qeverisë u bë përsëri BDI-ja. Kjo i ndërlikoi gjërat. E kur Besa refuzoi ta pranojë imponimin për ta mbështetur kandidatin e BDI-së për kryetar Kuvendi, kështu duke i qëndruar besnik votuesit dhe parimit të saj për sistemin e ri të vlerave ("nuk pranojmë imponime të vendosura diku

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 15 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

tjetër dhe figura të kapura”), e veçmas kur refuzoi të marrë pjesë në qeveri pa marrëveshje të nënshkruar dhe me kushte të imponuara nga mandatarin, atëherë gjërat ndryshuan. Sa për informacion, Besa i kishte ofruar LSDM-së të nënshkruajnë marrëveshje për bashkëqeverisje, duke e precizuar mënyrën e vendim-marrjes, programin e përbashkët qeveritar të afatizuar, bashkë me RIDE-FINIMIN, dhe ndarjen e pushtetit në mënyrë vertikale, horizontale dhe ndarje në bazë të resorëve veçmas. Atëbotë drejtuesit e LSDM-së na shikonin me syrin “a jeni në mend ju çka kërkonit?; ne e kemi në dorë një parti me 10 deputetë, që nuk kërkon këso gjëra, ndërsa ju me 5 deputetë shisni mend”. Në fund të bisedimeve Zaevi na tha se “nëse nuk vini në qeveri (pra, pa marrëveshje), do ju mbetet akuza se jeni me VMRO-në”. Kujtuani se do të dorëzohemi. Por, edhe ata që kishin menduar se Besa “by default” duhej të ishte në bllok me LSDM-në u stepën kur panë se Besa e ka me gjithë mend dhe jo vetëm për propagandë se është subjekt Autentik dhe Autonom. Madje, edhe kur iu kanosën se “qëndrimi jashtë qeverisë, në vend se të vlerësohej si pika kulmore e historike e një partie politike, ajo do të interpretohej si koketim me VMRO-në”, Besa përsëri mbeti stoike se më të rëndësishme janë parimet sesa përfitimet. Sepse për Besën politika nuk ishte vetëm numra, por para së gjithash parime. Ndryshe i bie që Merkel duhej të bënte qeveri me fashistët, sepse ashtu i bënte numrat. (Për informacion: Merkel i ka numrat që ta bëjë qeverinë me partinë naziste, por ajo do të detyrohet ta bëjë qeverinë me SDP-në vetëm që të mos e lejojë të vijë në pushtet fashistët. Pra, për të më të rëndësishme janë parimet se pushteti.) Kështu Besa, po e them pa modesti - për herë të parë në historinë e shqiptarëve të Maqedonisë, dëshmoi se ka shqiptarë që nuk janë në shitje për poste, se ka shqiptarë që politikën e bëjnë ndryshe, se ka shqiptarë që dinë të heqin dorë nga privilegjet në favor të parimeve. Sidoqoftë, spin-doktorët me honorarë të pushtetit e bënë të veten. Meqë Besa nuk iu nënshtrua këtij diktati, pra që të shitej me çmimin që ia kishte caktuar dikush tjetër, u vu në shërbim agjenda e parë - “SHPIFJE DHE AKUZA”: iu sulën me të gjitha mjetet dhe me të gjitha armët që ta njollosin dhe ta nxijnë me akuzat më të pështira e më të poshtira, që edhe sot e gjithë ditën nuk prajnë. Dhe, dorën në zemër, një pjesë bukur e mirë e opinionit, që është e thyeshme më lehtë, e hëngri këtë karrem dhe në vend se ta pranojë si vlerë qëndrimin parimor të Besës, që më në fund kishte një parti që e mban besën dhe fjalën ndaj votuesit, filluan të besojnë në shpifjet e akuzat që i gatuanin honoraristët e pushtetit.

Qyshkure kishim themeluar Besën, ne ishim bërë gati për këso sfidash, andaj jemi të bindur se edhe kjo rrufë do të kalojë dhe Besa patjetër do të ngadhënjejë. Idealistët e Besës do të vazhdojnë të rezistojnë deri kur pushteti maqedonas të maturohet politikisht dhe relacionin e ndërsjellë ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve të mose ndërtojë në saje të fuqisë dhe nënshtrimit, por në saje të dialogut, koordinimit dhe ndarjes simetrike të pushtetit



ELIMINIMI POLITIK

Dhe, derisa pushteti po etablohej dhe Besa përsëri ndihmonte në gjëra që qeveria nuk i kalonte dot vet, kjo për hir të parimit se “nuk jemi nihilistë të refuzojmë dhe mohojmë gjithçka, por jemi parimorë duke i mbrojtur kërkesat e votuesit tonë”, erdhën zgjedhjet lokale, në të cilat erdhi në shprehje edhe më mirë dhe më saktë qëndrimi i partive maqedonase se “partitë shqiptare, që nuk nënshtrohen, duhet të luftohen deri në eliminim”. Natyrisht, pasi të nxihen në sytë e opinionit, që gati u arrit përmes luftës mediale. Pas kësaj vijoi faza e luftës së drejtpërdrejtë politike pa pardon. Kështu, edhe pse LSDM-ja e kishte akuzuar gjatë gjithë kohës BDI-në se ishte parti “e regjimit”, “e korrupsuar”, “e inkriminuar”, “e kriminalizuar”, “e kapur nga VMRO-ja”, si “parti që kishte inskenuar vrasje si ajo e Kumanovës dhe tragjedi të tjera”, as kjo nuk i pengoi asaj që ta bëjnë bashkë qeverinë dhe, bile, të shkojë më tej. Diçka që Merkel sigurisht nuk do ta bënte, e bëri Zaevi. Me një fjalë, ai u ra kalem krejt këtyre gjërave dhe këtë e bëri përmes lavatriçes së tij “Prokuroria Speciale”, e cila sot i ndjek vetëm kriminelët e VMRO-së dhe i ka harruar ata të BDI-së. Thua jse ata ishin engjëjt dhe thua jse ne i kemi harruar përgjimet që vet Zaevi i kishte publikuar. Këtë ia thashë Zaevit në mbledhjen e votimit të Qeverisë: “Ati ke gënjyer se ata të BDI-së janë të korrupsuar apo ata janë të ndershëm dhe ti ke shpifur?! Të dyja nuk mund të jenë të sakta. Sepse, se ata janë të tillë ne me shumicë e kuptuam pikërisht nga ti.” Por, në këtë dalli dhe dehje, si në kohën kur kishte ardhur Tito në pushtet në ‘45-tën, më duket se askush nuk e dëgjoi këtë. Kjo i bie që për partitë maqedonase vazhdon të vlejë maksima “shqiptar i mirë është ai që unë e kam në dorë; të tjerët duhet eliminuar”. Në këtë frymë, pa dashur të bëj përgjithësime dhe më përgjithësi për çdo respekt, por nga shqiptarët që i favorizoi ai doli se tipi i shqiptarit të dëshirueshëm prej tij është shqiptari i padijshëm dhe i kapur. Pra, sipas tyre, secili shqiptar që ka tru autonom dhe që nuk është i kapur është shqiptar që duhet të luftohet dhe zhvlerësohet. Prandaj, shikoni pak se e kë e favorizoi dhe ndihmoi ai në zgjedhje lokale dhe e merrni vesh këtë. Për shkak të kësaj qasjeje, për fat të keq si asnjëherë më parë, sot në mjediset shqiptare vlon nga kriminelët që sillen si kapadainj dhe torturojnë e vrasin si ua ka ëndja, ndërsa shqiptarët e ndershëm janë struktur dhe nuk bëzajnë.

Këtu edhe është shpjegimi i luftës së pushtetit ndaj partisë së panënshtuar. LSDM-ja në zgjedhje lokale u bë bashkë me BDI-në për ta luftuar BESËN (dhe Aleancën për Shqiptarët) dhe, madje, përkundër asaj se edhe ndërkombëtarët ia

zunë për të madhe kryeministrit se po bënte dëm që po ndërhynte në vullnetin shqiptar, ai u tha shqiptarëve se “tash unë vendosi edhe për komunitatet e juaja dhe se ju nuk vendosni më për asgjë fare”. Ky ishte zhvlerësimi më i madh politik që ndonjë parti maqedonase kurdoherë ua ka bërë shqiptarëve në Maqedoni. Duke e kapur BDI-në, ai i kapi të gjithë shqiptarët dhe, thjesht, u dërgoi mesazh se “nëse doni të jeni fitues dhe në pushtet, patjetër duhet të më nënshtroheni mua”. Dhe, ata që nuk u nënshtruan, nuk fituan. Rezultati tashmë dihet.

DIVIDE ET IMPERA

Pasi që kishte përfunduar kjo fazë, pra pasi që partia më e madhe shqiptare ishte nënshtruar, ndërsa partitë e tjera ishin lënduar, pasoi faza e fundit - përpjekja për zhbërjen e plotë të partive të panënshtuara. Kjo fazë është në zhvillim e sipër tashmë në Lëvizjen BESA dhe flitet se e pret edhe Aleancën për Shqiptarët.

Ndonëse opiniononi e di saktë se kush e ka ideuar Besën, kush ia ka vënë 3 A-të, kush e ka bërë platformën RIDEFINIMI, kush ka artikuluar ide nga Besa, sot në Besa kemi fenomenin e mospërgjegjësive, të luftës së egër për fron, fenomenin e inatçinjve që e dëgjin jorganin për shkak të pleshtit, fenomenin e provincialistëve që “më mirë pranojnë të jenë të parët në Llërcë se të fundit në Shkup”, që në përgjithësi i shërbejnë - me ose pa vetëdije - agjendës së zhbërjes së një partie të panënshtuar. Nëse i shikoni me kujdes fotografitë e taborëve në BESA, në njërin anë janë ata që gjatë gjithë kohës sulmoheshin me akuza e shpifje dhe, në anën tjetër, janë ata që gjatë gjithë kohës koketonin me pushtetin. Ose, shprehur me gjuhë politike, në njërin anë janë idealistët, në tjetrën oportunistët. (Shpjegim: oportunistët janë personat joparimorë, që ndërtojnë një mendësi morale duke u bazuar në prirje të çastit dhe, shikuar nga aspekti psikologjik, ata shquhet për lëkundje dhe labilitet.) Brenda grupit të oportunistëve është edhe një nëngrup tjetër, edhe më perfid - “instrumentalistët”. Ndonëse për nga numri janë shumë më pak, ata arrijnë t'i instrumentalizojnë oportunistët, duke i yshtur në pafundësi në “avangardën” oportuniste. Natyrisht, instrumentalistët kanë më shumë mbështetje dhe përkrahje nga pushteti, sepse ata e kryejnë një detyrë të rëndësishme - përpjekjen për eliminim të politikanëve të panënshtuar. Këtë as VMRO-ja e as LSDM-ja nuk kanë arritur ta bëjnë vetë.

HAPPY END

Dhe, kur i dëgjon ofkëllimat e aktivistëve dhe votuesve që nuk e durojnë dot këtë përplasje, natyrisht se si njeri të vjen keq dhe e vuan,

por kur e shikon organizimin politik në shiritin e historisë, gjithnjë e ke në mendje se më e rëndësishme është të mbrohet ideali, edhe me çmimin e jetës, sesa ta pranohet nënshtrimi vetëm për shkak të përfitimit. Azem Morana dhe shokët e tij të NDSH-së (ose edhe Sulë Hotla me ushtarët e tij) e dinin se suksesi i betejës së tyre ishte në kufi të pamundurës, por ata nuk u nënshtruan. Dhe, ata janë sot burim i idealit tonë për ta vazhduar misionin, e jo ata komunistë, si Nexhat Agolli etj., që u bënë argat të komunizmit, ndërsa në kthesën e parë e hëngrenë kokën e vet.

Gjithë kjo i ka dy shpjegime. I pari, pra, është historik. Pavarësisht si do të jetë epilogu në BESA, do të jemi lumtur nëse dikur diku do të shënohet se në vitet 2014-2018 ka pasur shqiptarë të rinj që kanë prodhuar një subjekt politik ndryshe, që nuk janë nënshtruar ndaj asnjë partie maqedonase, që kanë artikuluar një vizion autentik politik, që kanë afirmuar vlera morali dhe kanë qenë kundër kriminit, korrupsionit dhe amoralitetit, që e kanë shqiptuar drejt e pa ekuivoke interesin shqiptar, që nuk janë trembur as kur i ka kërcënuar VMRO-ja e as kur i ka shpifur e luftuar LSDM-ja, që nuk janë nënshtruar as ndaj presioneve as ndaj privilegjeve dhe që në fund këtë kokëfortësi (ashtu i thëncin) ose bindje parimore e kanë paguar me eliminim nga skena politike, pasi që në të kanë futur elementë, që e kanë bërë me sukses këtë vazifë, ose i kanë kapur disa drejtues të saj, që e kanë kryer këtë detyrë me sukses.

Shpjegimi i dytë është se kjo përçarje dhe ky tension është normal për partitë politike në sisteme pluraliste. Mund të na vijë keq, por për organizatat e mëdha, siç është relativisht edhe Besa, këto gjëra janë krejt të zakonshme. Prandaj, ideatorët dhe idealistët e Besës do ta tejkalojnë edhe këtë grip, duke mos u nënshtruar as kësaj radhe, ani se disa kanë devijuar dhe nuk kanë mundur ta durojnë presionin. Ne do të vazhdojmë t'i shërbejnë idesë së Besës të bindur se kjo ide do të ngadhënjejë një ditë. Në maratonë ka plot garues që nuk arrijnë ta përfundojnë garën dhe dorëzohen. Prandaj maratonën nuk mund ta përballojë secili. Kondicioni është mbi të gjitha. Ndërsa ne kemi kondicion më shumë seç mund të na bëjnë ata presion. Qyshkur e kishim themeluar Besën, ne ishim bërë gati për këso sfidash, andaj jemi të bindur se edhe kjo rrufë do të kalojë dhe Besa patjetër do të ngadhënjejë. Idealistët e Besës do të vazhdojnë të rezistojnë deri kur pushteti maqedonas të maturohet politikisht dhe relacionin e ndërsjellë ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve të mos e ndërtojë në saje të fuqisë dhe nënshtrimit, por në saje të dialogut, koordinimit dhe ndarjes simetrike të pushtetit.

**NDRYSHE ME BERAT DEHARI,
ZËVENDËSDREJTOR I POLICISË
FINANCIAR**



PROCESET DEMOKRATIKE NISËN ME 2001-shin

Dukuria e ekonomisë informale ose ekonomia e zezë është e lidhur ngushtë me të kaluarën. Për luftimin e kësaj dukurie fillimisht duhet punuar në vetëdijesim të qytetarëve dhe t'ju bëhet me dije atyre se një gjë e tillë nuk është në dobi afatgjate të tyre dhe të shoqërisë gjë që na bën të kuptojmë se në vendin tonë ekziston ekonomia e zezë por aparati shtetërorë dita ditës po punon që këtë aktivitet ta fus në binare dhe ta ndalojë atë duke ofruar forma të ndryshme të ndihmës...

Koha

Delvina KËRLUKU

Berat DEHARI, lindi më 3 Janar 1982, në Debresh të Gostivarit. Arsimin fillor e kreu në vendlindje, ndërkohë që shkollën e mesme në SHMK "Moshë Pijadi" - Tetovë, vitet 1997-2001. Fakultetin në drejtimin E Drejta Penale, në Universitetin e Evropës Juglindore, në Tetovë më 2001-2005, ku dhe ka kaluar provimet të Jurisprudencës dhe Noterisë. Ka marrë titullin magjistër i shkencave Kriminologjike, dhe është PhD Kandidat pranë American College - Shkup. Aktualisht është zëvendë-

sdrejtor i Policisë Financiare. Ka qenë pjesëmarrës në disa konferenca dhe trajnime ndërkombëtare (profesionale dhe politike). Njeh disa gjuhë të huaja. Është i pasionuar pas sportit me motor. Dehari është i martuar dhe ka një djalë.

KOHA: Zoti Dehari, shumica e lexuesve nuk i dinë aq me saktësi kompetencat e policisë financiare. Mund të na thoni ku fillojnë dhe ku mbarojnë ato?

DEHARI: Fillimisht ju faleminderit për hapësirën, ju uroj për këtë rubrikë të qëlluar. Ne si organ e kemi

ligjin material, i cili është ligji mbi policinë financiare dhe disa ligje që ne i shfrytëzojmë në përditshmëri, kompetencat e veprimit tekstualisht janë shumë të zgjeruara, do mundohem ti përmendi disa nga ata:

- Të zbulojë dhe kryejë hetim kriminal të veprave penale që mund të ndiqen sipas detyrës zyrtare siç janë: larja e parave dhe të hyra tjera nga vepër e ndëshkueshme, tregti e palejuar, kontrabandim, fshehje tatimi dhe vepra tjera penale me dobi pronësore të kundërligjshme me vlerë të konsiderueshme, si dhe kapja dhe paraqitje të kryerësve të

tyre, sigurimi i provave, masa tjera dhe aktivitete që mund të shfrytëzohen për mbajtjen e papenguar të procedurës penale me detyrë zyrtare ose me urdhër të prokurorit publik nëpërmjet realizimit të kompetencave në policinë e jurispruencës në pajtim me ligjin;

- Mbledhë dhe analizojë të dhëna për transaksione në para të gatshme, të ndërmarrë masa para hetuese dhe masa tjera kur ekzistojnë bazë të dyshimit për vepra penale të kryera, e ndjek gjurmën e parave me qëllim të zbulimit të veprave të ndëshkueshme të përcaktuara me

ligj, kryen hetim dhe kontroll të të dhënave të kontabilitetit dhe evidencave në sistemet kompjuterike në prani të personit përgjegjës ose personit të autorizuar nga ai dhe kryen punë tjera në pajtim me ligj;

- Kryejë analizë kompjuterike forenzike të sistemeve kompjuterike të marra përkohësisht, dhe aparateve tjera elektronike;

- Paraqesë kallëzime penale të prokurorit publik kompetent për vepra penale nga kompetenca e vet, të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare;

- Paraqesë iniciativë për ngritjen e procedurës tatimore dhe procedurës tjetër për përcaktimin dhe arkëtimin e taksave publike para organit kompetent;

- Koordinojë, japë iniciativë, paraqesë kallëzime penale, kryejë këmbim të informatave dhe organizojë trajnime për personat e përfshirë në si sistemin e parregullsisve me qëllim të mbrojtjes së interesave financiare të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian;

- Kryejë punë tjera të përcaktuara me ligj.

KOHA: Ju më tepër ndiqni evazionin fiskal të kompanive të mëdha, apo atyre të voglave dhe pse? Ose, kush është më i prirur t'i shkelë ligjet dhe rregullat e lojës?

DEHARI: Zakonisht policia financiare nuk bën dallime në mes kategorisë së bizneseve se a janë kompani të mëdha apo biznese të vogla por, ajo që i intereson Policisë Financiare është se sa këto kompani i kryejnë detyrimet ligjore dhe a ka shkelje të tyre. Nga përvoja jonë kemi pasur raste nga më të ndryshmet qofshin ato të mikro apo makro bizneseve, por përsëri nuk mund të tërhiqet një vijë e kuqe apo një kufij ndarës, i cili do të përcaktonte se cilët nga kategoritë e lartë përmendura janë më tepër shkelës të ligjit.

Që të jetë më e qartë për opinionin "Ne jemi ruajtës të arkës shtetërore" apo ndryshe nëse bëhet komparacion me organ tjetër të ngjashëm, organi ynë konsideron të jetë i përafërt me "Guardia di Finanza", të Italisë.

KOHA: A ka ndodhur të kontrolloni ndonjë kompani që është e lidhur në mënyrë direkte ose indirekte me "bosat" e pushtetit?

DEHARI: Përgjigjen e kësaj pyetje do ta jap duke i qartësuar katër zerot (numrat) që janë pjesë përbërëse e logos së Policisë Financiare që nënkupton: Zero Tolerancë, Zero Korrupsion, Zero fshehje tati mi dhe Zero keqpërdorim, andaj kjo nënkupton atë se nga llupa jonë nuk mund të fshihen kryerësit të cilët mendojnë se kanë të veshur jakën e pushtetit ose siç ju i quajtet "Bossat e pushtetit". Ndërsa kategorizimin e kryerësve e ndajmë në: Persona Fizik dhe Persona Juridik dhe aspak ndryshe. Në opinionin kanë qenë të njohura disa raste në të kaluarën e afërt që përmes konferencave për media i kemi publikuar, qofshin ato individ apo subjekte të ndryshme.

KOHA: A mund të na thoni si lulëzoi gjithë ky korrupsion (e zbardhur nga përgjimet e famshme) para hundës së policisë financiare?

DEHARI: Për një luftë efikase kundër kriminalitetit duhet pasur parasysh se nevojitet një bashkëpunim i rregullt në mes shumë organeve shtetërore siç janë: MPB-ja, DAP-i, Komisioni për antikorrupsion, dhe të tjera si këto, duhet që mes veti të jenë në koordinim të vazhdueshëm, andaj faji nuk mund të adresohet vetëm te një organ ose te një grup i caktuar njerëzish, andaj Policia financiare nuk mund drejtpërdrejt të akuzohet pasi kompetencat e saja janë të qarta në Ligj dhe njëkohësisht edhe mundësitë e saj operative-teknike në krahasim me disa institucione tjera kanë qenë shumë më të kufizuara, duke marrë parasysh edhe veprimin politik, menaxhimin qeverisës në vitet e fundit do të kemi më qartë këtë që pyetni, mirëpo vlen të thuhet se procedurat para hetimore dhe disa nga procedurat që janë në zhvillim të sipërm janë kryesisht të iniciuara dhe të hetuara po nga ky organ edhe pse publikisht nuk parapëlqejmë që të "marrim bajrakun".

KOHA: Ç'përqindje zë ekonomia informale (allëshverishi i zi) në vendin tonë?

DEHARI: Dukuria e ekonomisë informale ose ekonomia e zezë është e lidhur ngushtë me të kaluarën. Për luftimin e kësaj dukurie fillimisht duhet punuar në vetëdijësim të qytetarëve dhe t'ju bëhet me dije atyre se një gjë e tillë nuk është në dobi afatgjate të tyre dhe të shoqërisë gjë që na bën të kuptojmë se në vendin tonë ekziston ekonomia e zezë por aparati shtetërorë dita ditës po punon që këtë aktivitet ta fus në binare dhe ta ndalojë atë duke ofruar forma të ndryshme të ndihmës si psh: Subvencionet e ndryshme,



ndihmë juridike dhe të tjera si këto që lehtësojnë punën e themelimit, duhet të kemi konsideratë se shteti ynë ka qenë në tranzicion vite me radhë dhe kjo dukuri është pak vështirë që të mënjanohet aq lehtë, duke marrë parasysh edhe llojin e tregtisë që bëhet, konsiderata e tregtarëve të vegjël, qofshin ata rural që e kanë të hyrë primare ekzistencën e tyre.

KOHA: Cili është fillimi i vështirësisë dhe i lehtësisë në karrierën tuaj profesionale?

DEHARI: Si çdo punë dhe profesion tjetër, edhe kjo lloj pune ka karakteristikat e saja të cilat e bëjnë të dallueshme nga të tjerat. Ndërsa vështirësitë janë të zakonshmet që mund ti ketë një fillim karriere duke u nisur që nga ndryshimi i ambientit, përkushtimi dhe dedikimi i kohës më shumë ndaj punës dhe aktiviteteve tjera që janë drejtpërdrejt të lidhura me to, do të kisha thënë se nuk mund të ketë ndonjë limit i të

qenurit profesionist dhe të thuhet se tani është kulminacioni i dijes, njeriu sa jeton aq edhe mëson kështu që çdokush ka nevojë për përbushje dhe dije.

Fillimi im ka qenë punësimi i parë në vitin 2006 i punësuar në konkursin e Qeverisë të asaj kohe "100 studentët më të mirë në RM" dhe atëkohë ishin edhe zgjedhjet parlamentare dhe ndërimi i pushtetit, ku gjatë dy viteve në vazhdim në pushtet ishte VMRO-PDSH. Unë isha i punësuar në Inspektoratin shtetërorë të administratës që atëherë ishte në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, mbi të gjitha përvojë e mirë!

KOHA: Të rinjtë duhet të jenë motor i ndryshimeve në jetën politike? Çfarë ju lidh me politikën?

DEHARI: Politika duhet parë dhe funksionon tamam si një motor, i cili bën ndryshime në aspektin pozitiv, ndërsa e dimë që një motor për të

lëvizur i nevojitet një forcë shtytëse ose burim energjie nga ku do të furnizohet dhe do të lëviz, pikërisht të rinjtë duhet të jenë ajo forcë shtytëse ku edhe unë e kam gjetur veten dhe politikën vazhdimisht e kam parë si një fushëveprim ku mund të kontribuohet në të mirë të shoqërisë andaj që në moshë të re kam filluar aktivitetet e mija politike përmes të cilave kam shprehur botëkuptimin tim.

Që nga themelimi i Bashkimit Demokratik për Integrim kam qenë i kyçur në strukturat e Forumit Rinor dhe më vonë edhe në strukturat tjera, nga këtu edhe hapërimet në vazhdim i kam bërë në mënyrë paralele në ngritjen e aspektit profesional dhe atë politik.

KOHA: Mendoj se ndonjëherë, në Maqedoni harrohet se vendi ka dalë nga një luftë. Pas çdo lufte, ka më pak demokraci për të shpëtuar?

DEHARI: Falë shoqërisë tonë që



në masë të madhe kemi vepruar dhe veprimet në shtetet e zhvilluara me demokraci dhe është e natyrshme që atë nivel ta bartim edhe në Maqedoni. Shqiptarët e kanë njohur demokracinë edhe para pluralizmit në Maqedoni, mendoj që një pjesë e madhe e kemi gjetur veten më të përgatitur në sfidat që kanë pasuar. Nëse e keni për konfliktin e 2001-shit, unë do të kisha thënë se nga aty fillojnë të frymojnë proceset demokratike.

KOHA: Një nga forcat që shtynë individin drejt formimit intelektual, kulturor dhe social është edukatori. Mësuesi është forca shtytëse në shkollë, prindërit janë forca në familje, shokët dhe shoqet apo miqtë janë forca në shoqëri. Sa kanë luajtur rol këto, në jetën tuaj?

DEHARI: Familja si njësi themelore e formimit të shoqërisë dhe dedikimi i saj janë faktor kyç për ndërtimin e një individi, dhe kur kjo bazë kulturore e fituar në familje arin të kombinohet me elementin e edukimit të cilin mësuesit tanë kanë bartur nëpër gjenerata me gjithë pengesat e shumta padyshim që kanë luajtur rol të rëndësishëm duke e dekoruar me motivimin, përkrahjen dhe shtytjen e shoqërisë të cilët sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë përkrahësit e mi dhe të më japin forcë për të vazhduar më tutje.

KOHA: Sa e menaxhoni kohën, e cila është e rëndësishme për ata që dëshirojnë që të kenë një jetë të ekuilibruar profesionale dhe personale?

DEHARI: Padyshim koha është shumë e vlefshme. Nga faktori kohë mëson atë që nuk mund ta mësosh edhe sikur të shfletosh literatura të shumta, pikërisht kjo vjen si rezultat i menaxhimit të kohës në mënyrën sa më të mirë të mundshme. Gjithmonë ekziston hapësirë për të ndarë momente apo çaste edhe për ata që të japin stimul apo që i mbushin bateritë për atë që nesër do ta shfrytëzojë në aspektin profesional, nga 24 orë gjendet hapësirë për gjithçka, mjafton të kesh vullnet.



PASAPORTA QË NUK TË ÇON ASKUND

Me pasaportë të Kosovës, përveç shteteve të rajonit ku mund të shkosh pa viza, si në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni - nuk mund të shkosh askund. Derisa ne, si qytetarë, nuk kemi mundësi të udhëtojmë pa viza, liderët e institucioneve kanë marrë pasaporta të Shqipërisë, me të cilën ata mund të udhëtojnë në vendet e BE-së, por jo edhe ne qytetarët

Pasaporta e Kosovës në radhitjen e fundit ndërkombëtare të fuqisë së saj, është renditur në vendin e 96-të, marrë parasysh se qytetarët e saj mund të udhëtojnë në vetëm 38 vende të botës pa viza. Vendin e 96-të, Kosova e ndan me Iranin. Pasaporta më e "fuqishme" është cilësuar ajo e Gjermanisë, e cila u jep qytetarëve qasje në 177 vende të botës. Derisa vendin e fundit, të 104-të, e mban pasaporta e Afganistanit. Ky është rezultati i një hulumtimi të kompanisë 'Henley Passport Index', që flet për fuqinë e pasaportave të sh-



teteve të botës, bazuar në 'lirinë e lëvizjes së bartësit të një pasaportë në shtete të ndryshme, pa pasur nevojë për vizë'. Qytetarë të anketuar nga Radio Evropa e Lirë ndajnë të njëjtin mendim me këtë hulumtim. Ata thonë se pasaportën e tyre shumë pak e shfrytëzojnë, pasi që në vendet si ato të Bashkimit Evropian iu duhet të pajisen me vizë. Merita Kastrati, studente në Universitetin e Prishtinës e konsideron pasaportën e Kosovës si një pasaportë jo edhe aq të vlefshme, për faktin, siç thotë ajo, "nuk mund të udhëtosh me të në asnjë nga vendet e BE-së". "Me pasaportë të Kosovës askund nuk mund të udhëtosh. As që e kam përdor ndonjëherë. Në Shqipëri e Maqedoni atje ku shkoj më shpesh, udhëtoj vetëm me letërnjoftim. Pasaportën e mbaj në dollap nuk më hyn në punë fare", thotë

ajo. Ngjashëm shprehet edhe Arjeta Sylejmani. "Unë e kam pasaportën e Kosovës, por po presim që po bëhet liberalizimi i vizave, përndryshe me pasaportën time nuk mund të udhëtoj askund". Adonis Kryeziu, qytetar nga Prishtina, thotë se është pajisur me pasaportë biometrike të Kosovës qysh para dy viteve kur edhe ishte premtuar se Kosova do të ketë liberalizim të vizave. Megjithatë, ai thotë se këtë pasaportë nuk e ka përdorur as për një herë të vetme. "Me këtë pasaportë të Kosovës, përveç shteteve të rajonit ku mund të shkosh pa viza, si në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni - nuk mund të shkosh askund. Derisa ne, si qytetarë, nuk kemi mundësi të udhëtojmë pa viza, liderët e institucioneve kanë marrë pasaporta të Shqipërisë, me të cilën ata mund të udhëtojnë në vendet e BE-së, por

jo edhe ne qytetarët", thotë Kryeziu.

Një numër i madh i udhëheqësve shtetëror, i deputetëve, por edhe i njerëzve me funksione të larta, kanë shtetësinë e Shqipërisë dhe pasaportat, për të cilat nuk vlen regjimi i vizave me Bashkimin Evropian. Përmes dekretit të presidentit të Shqipërisë, gjatë kësaj jave pasaportën e Shqipërisë e ka marrë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe bashkëshortja e tij, Anita. Ndërkaq, duke u thirrur në të drejtën e dyshetësisë, pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë e kanë shfrytëzuar të drejtën që të pajisen me dokumente të Serbisë. Njësoj, kanë vepruar edhe qytetarët shqiptarë nga Lugina e Preshevës, të cilët jetojnë në Kosovë, por posedojnë dokumente të Serbisë. Përveç qytetarëve, të cilët thonë se me pa-

saportën e Kosovës nuk arrijnë të udhëtojnë në vendet e BE-së pa viza, me këtë problem po ballafaqohen edhe kompanitë vendore. Sylejman Konushevi pronari i kompanisë "Inter Company", që merret me prodhimin e vajit ushqimor, kohë më parë i kishte thënë Radios Evropa e Lirë se ka qenë i detyruar të punësojë shoferë nga vendet tjera të rajonit që kanë pasaportë, më të cilën udhëtojnë pa viza. Pamundësia për të lëvizur pa viza në vendet e BE-së, e ka detyruar atë që të largojë nga puna qytetarë nga Kosova dhe të punësojë qytetarë nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe nga rajoni. "Të gjithë shoferët që kemi për transport ndërkombëtar, i kemi nga shteti i Maqedonisë dhe Bullgarisë, kurse maunet i kemi të regjistruara në Kosovë. Pra, për shkak të mungesës së liberalizimit detyrohemi të punësojmë qytetarë nga vende të ndryshme, që kanë mundësi të lëvizin pa viza", ka thënë Konushevi. Liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës po e mban peng mosratifikimi i demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Mungesa e ratifikimit, ndërlikohet me kundërshtimet e brendshme nga një pjesë e spektrit politik, i cili vlerëson se me anë të kësaj marrëveshjeje, Kosova ka humbur mbi 8 mijë hektarë tokë. Thirrjet ndërkombëtare për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi datojnë për më gjatë se dy vjet.

MASAKRA QË NDËRROI FATIN E KOSOVËS POR QË MBETI PA DREJTËSI

Atë ditë të ftohtë dimri - më 15 janar 1999, në Reçak, forcat serbe vranë dhe masakruan 44 civilë shqiptarë. Pasi e pa me sytë e tij këtë skenë, shefi i misionit të OSBE-së, William Walker, alarmoi se në Kosovë po ndodh krim kundër njerëzimit, gjë që shtyu bashkësinë ndërkombëtare të ndërmarrë misionin ushtarak, pas të cilit forcat serbe u tërhoqën nga Kosova



Masakra e Reçakut në Shtime ishte ngjarja që ndryshoi fatin e Kosovës gjatë luftës së fundit. Dje, kur u mbushën 19 vjet nga kjo ngjarje që tronditi botën, atje mbahen homazhe e akademi përkujtimore nën patronazhin e presidentit të republikës, Hashim Thaçi. E ata që mbijetuan, tani duan drejtësi. Po mbushën 19 vjet nga masakra e Reçakut ku më 15 janar 1999 forcat paramilitare serbe masakruan burra gra pleq e fëmijë. Të freskëta janë kujtimet e atyre që përjetuan nga afër këtë

masakër. Ymer Ymeri kujton ditën e masakrës ku para fytyrës ju vra djali. "Jemi kanë tek ajo shtëpia aty janë ardhur serbet. Aty na kanë zanë dhe na kanë çu drejt përpjetë, kishe po shkojmë në mal. Drejtë e përpjetë kur jemi dal aty tjerë policë ishin kanë aty këta u kthyen në shpat aty tha ku shkoni irredentistë atë nënë kështu ashtu në gjuhën e vetë shajshin dhe ka kris menjëherë automati, 24 janë ra me një vend për toke. Atëherë jam rrotullue në një krah jam ra, djali para meje ke", tregon



Ymeri. Ditën e 15 janarit e kujton edhe Sabit Shaqiri i cili humbi vëllanë dhe shumë të afërt të tjerë. "Ditë e enjte o konë në mbrëmje o kanë natë e madhe të premtën në sabah krismat janë dëgjue në 7 e 15 u nisë loja. Në orën 2 e 15 është ardhë kolona prej së larti ata e kishin krye masakrën e tmerrit dikush pa krye dikush pa këmbë dikush pa sy pa gjymtyrë të trupit. Tmerr ma i zi nuk ka pas qysh", tregon Shaqiri. Ymeri e Sabiti tani kërkojnë që drejtësia të dënojë autorët e kësaj masakre Ymer Ymeri

i mbijetuar i masakrës së Reçakut. "Mi denuë shteti se kjo ky ka qenë krim i madh, 24 në një vend mi pre ka pas fëmijë pleq", tha Ymeri. "Kërkoj me dal para drejtësisë se na jemi kanë njerëz të pa fajshëm", ka thënë Shaqiri.

Për të rikujtuar 15 janarin, nën patronatin e presidentit të vendit Hashim Thaçi, të hënë në orën 9:00, u mbajtën homazhe në kompleksin Përkujtimor në Reçak kurse në orën 11 shtëpinë e Kulturës në Shtime mbahet Akademia Përkujtimore.




Trump, një budalla i armatosur me armë bërthamore

Shkrimi ynë i fundit shpjegon dhe gërmon në pasojat e një Amerike dhe një bote që u përball me një budalla të armatosur me armë bërthamore që me gjasë do të jetë edhe ca kohë në zyrë dhe që nuk është as mendërisht dhe as psikologjikisht i përshtatshëm për detyrën - mesa duket as fizikisht...

"Epoka e zjarrit dhe tërbimit", kjo është kopertina e revistës gjermane "Spiegel", duke ironizuar reagimin e Trump ndaj librit me të njëjtin titull të gazetarit Michael Wolff, shkruan Der Spiegel. Revista e sqaron në faqen online arsyen e kopertinës, përmes një shënimi të zv.kreredaktores, Susanne Beyer, sipas së cilës kopertina dhe shkrimi ecin më tej në kontekstin e ekspozimit të presidentit pas publikimit të librit. "Shkrimi ynë i fundit shpjegon dhe gërmon në pasojat e një Amerike dhe një bote që u përball me një budalla të armatosur me armë bërthamore që me gjasë do të jetë edhe ca kohë në zyrë dhe që nuk është as mendërisht dhe as psikologjikisht i përshtatshëm për detyrën - mesa duket as fizikisht duke patur parasysh sesa vonë ai e nis dhe sa shpejt e mbyll ditën e punës. Njerëzimi si i gjithë është shtyrë pas për shkak të vetëm një personi...Ku supozohet se do t'ia nisë bota sërish nëse ja del t'i mbijetojë Donald Trumpit?", shkruan Beyer. Duket se Trump ka acaruar shumëkënd në Perëndim, jo me radikalizmin e tij verbal, më shumë sesa me budallallëkun e perceptuar gjerësisht, e më tej akoma me thjeshtësinë me të cilën di të prishë pazaret disa dekadëshe të konsoliduara nga një kod publik mediatik e moralizues që në fund solli edhe humbjen e Clinton.

ÇFARË DO TË BËJË EVROPA ME FËMIJËT E ISIS-it?



I ashtuquajturi "Shteti Islamik" ka humbur nga pikëpamja ushtarake. Por ideologjia e tij jeton. Për shembull tek fëmijët që janë rritur nën regjimin e IS-it. Sfidat pas fitores ushtarake kundër ISIS-it

Organizata terroriste "Shteti Islamik" gati është eliminuar në Siri dhe Irak. Sipas të dhënave të ushtrisë amerikane, xhihadistët kanë humbur 98% të territorit të tyre të uzurpuar në të dyja vendet. Sipas vullnetit të ushtrisë siriane, irakiane dhe amerikane atyre do t'u merret edhe 2% territori mbetur. Për të arritur këtë ushtria amerikane, sipas të dhënave të Pentagonit kreu një sërë fluturimesh nga 29 dhjetori deri në 5 janar - avionë luftarakë, drone, raketa, artileri e rëndë. Zëdhënësja e Pentagonit Dana W. White shprehet se IS-i vërtet është "mundur dhe shkatërruar", por puna nuk ka marrë fund. Tani bëhet fjalë për sigurimin e territorit, që "IS të mos ringrihet më". Por ky qëllim është i vështirë të realizohet. Vërtet IS mund të jetë shkatërruar në Irak e Siri, por ideologjia e tij vazhdon të jetojë. Sipas Pentagonit, IS është një organizatë e krijuar jo për një kohë të caktuar, por përmes një sistemi të pavarur shpërndarjeje ai siguron kontinuitetin e tij. "Megjithëse IS me kalifatin e tij është shkatërruar, shohim në të gjithë botën ngjarje që lidhen me IS".

LUFTË KUNDËR IMAZHIT TË IS

Prandaj tani bëhet fjalë për të luftuar imazhin e IS. Sipas vlerësimit të Pentagonit, shanset për këtë nuk janë të këqija. "Marka botërore IS" po humbet me rrënimin fizik edhe shkëlqimin e saj. Këtu bëjnë pjesë edhe historitë për jetën e tmerrshme nën sundimin e IS". Por përfundimisht IS nuk është mundur. Organizata xhihadiste po kthehet në formën e luftës guerilase, bën të

MASA NË GJERMANI

Edhe Gjermania do të rimarrë fëmijët e luftëtarëve të IS-it. Por që tani Mbrojtja Kushtetuese gjermane paralajmëron nga rreziku që vjen sidomos nga fëmijët në adoleshencë. "Ne shohim rrezikun që fëmijët e xhihadistëve janë socializuar si islamistë dhe kthehen të indoktrinuar nga rajonet e luftës në Gjermani", deklaroi presidenti autoritetit të Mbrojtjes Kushtetuese, Hans-Georg Maaßen. "Me këtë mund të ndodhë që të rritet këtu një gjeneratë e re xhihadistësh". Problemi duhet

të zgjidhet para se autoritetet e sigurisë të bëhen aktivë, thotë Torsten Voß, drejtues i zyrës së landit të Hamburgut për Mbrojtjen Kushtetuese. Ende nuk dihet, se si do të veprojë konkretisht Gjermania. Politikanë për çështjet e politikës së jashtme të të gjitha partive janë duke menduar priten vetëm pas krijimit të Qeverisë.



ditur televizioni Al-Jazeera. Vullnetarët përpiqen sërish t'u bashkohen radhëve të tyre, por kanë probleme që të hyjnë nga Turqia, për shkak të kufirit me Sirinë të siguruar ndërkohë. Por veç vullnetarëve që vijnë nga jashtë për t'iu bashkuar IS-it, autoritetet e sigurisë në Siri e Irak shohin edhe një problem tjetër - trashëgimia ideologjike e psikologjike e IS në zonën ku ka sunduar ai. Në shumicën e rajoneve, IS ka sunduar më pak se tre vjet, por për të rinjtë, tre vjet janë një kohë e gjatë, sidomos për fëmijët, që kanë përjetuar dhunën në moshë të vogël - si ekzekutimet publike të kryera me brutalitet të jashtëzakonshëm. "Edhe nëse ata nuk

janë të trajnuar qëllimisht, ata mbajnë me vete kujtimet e luftës nga zona të tilla", thotë Daan Weggemans nga Instituti për Sigurinë dhe Çështjet Globale në Universitetin Leiden për revistën online, Al-monitor.

GJENERATË E HUMBUR

Të rinjtë në vend që të mësonin shkrim e lexim janë marrë me armë. "Ka gjasë që po rritet një gjeneratë e humbur", thotë Nadim Houry, drejtor i projektit studimor Terror dhe Luftimi i Terrorit nga Human Rights Watch. Por edhe shumë të rritur kanë probleme të marra me vete në kohë e sundimit të IS-it.

Problemi me "gjeneratën e

humbur" pritet të arrijë shpejt në Evropë. Qindra fëmijë që u morën me vete nga prindërit e tyre në Siri dhe Irak apo ata kanë lindur atje. Ende shtetet evropiane nuk kanë vendosur si do të veprojnë me këta fëmijë. Belgjika do të lejojë që fëmijët nën 10 vjeç të udhëtojnë automatikisht. Kusht është një provë ADN-je që vërteton se fëmijët janë vërtet nga ushtarët belgë të IS-it. Vitin e kaluar u morën me avion tre fëmijë të tillë me pasaportë franceze në Paris. Parimisht edhe në Hollandë, fëmijët e luftëtarëve të IS-it mund të kthehen nga jashtë. Por qeveria holandeze nuk parashikon t'u japë atyre pasaportën holandeze. (DW)

VITIN E KALUAR MBI 15 MIJË FËMIJË TË PASHOQËRUAR ARRITËN NË ITALI

Më shumë se 15.730 fëmijë të pashoqëruar vitin e kaluar kanë mbërritur në Itali përmes detit, bën të ditur organizata "Save the Children". Nga organizata thonë se fëmijët kanë ardhur në Itali të vetëm, pa shoqëruar të anëtarëve të familjes ose mbikëqyrjen e një të rrituri. Më tej theksohet se kjo shifër në



vitin 2016 ishte 25.840. Po ashtu në deklaratë thuhet se më shumë se 380 fëmijë presin për strehim në Itali dhe se për 79 prej tyre nuk është gjetur strehim, pavarësisht se kërkesat e tyre u miratuan. Ndërkaq, 151 fëmijë presin për miratim nuk dihet identiteti i 154 fëmijëve të tjerë.

Ai ishte në pension kur Lufta e Parë Botërore shpërtheu, duke jetuar një jetë të qetë me studimet e tij të historisë ushtarake, por kur ai mori thirrjen, ai u kthye për të fituar triumfe mahnitëse, mori komandën e ushtrisë gjermane, dhe u bë një legjendë e vërtetë e gjallë, Paul von Hindenburg

Paul Ludvig Hans Anton von Benekendorf von Hindenburg, lindi në një familje junkerësh, një anëtar i aristokracisë së pronave që formuan elitën sociale, politike dhe ushtarake të shtetit Prusian, ai i përvetësoi vlerat konservatore të klasës së tij dhe ndoqi një karrierë ushtarake. Duke u bashkuar me rojet Gardën e Këmbësorisë Prusiane, si një oficer i ri në 1865, ai u zotua me betimin standard se do të ishte "një ushtar i ndershëm, i patrembur, i përkushtuar ndaj detyrës dhe i ndershëm". Nuk ka dyshim se si Hindenburgu e pa veten gjatë gjithë jetës së tij. Ai përjetoi në radhë të parë ngjarjet dramatike që krijuan Perandorinë Gjermane, duke shërbyer në luftërat fitimtare të Prusisë kundër Austrisë dhe Francës dhe duke dëshmuar shpalljen e mbretit të Prusisë si perandor (Kaiser) të Gjermanisë në Versajë në 1871, në fund të Luftës Franko-Prusiane.

I njohur si i fortë, i aftë dhe i besueshëm, ai bëri një karrierë të suksesshme përgjatë katër dekadave në ushtrinë e kohës së paqes, por gjithnjë i mungonin emërimet më të larta. Në vitin 1911, ai doli në pension - jo për shkak të "fërkimit profesional ose personal", por në përmbushjen e "detyrimit për të bërë rrugë për oficerët e rinj". Pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore në gusht 1914, të gjithë oficerët e pensionuar prisnin thirrjen për t'u kthyer në shërbim. Për Hindenburgun, ajo erdhi tre javë pas luftës. Shtabi i Përgjithshëm gjerman kishte vendosur që Erich Ludendorff, i cili e ishte dalluar në rrethimin e Liçges, ishte njeriu i duhur cili mund të përballonte situatën kërcënuese në Frontin Lindor.

Ludendorfi u emërua në Prusinë Lindore, ku ai do të merrte përsipër Shef Stafit. Ai kishte nevojë për një komandant ushtrie për t'i shërbyer. Hindenburg jetonte në Hanover, në rrugën hekurudhore që Ludendorff do të merrte nga Belgjika. Në mbrëmjen e 22 gushtit, ai u informua se ai do

PAUL VON HINDENBURG


HEROI I GJERMANISË NË LUFTËN E PARË BOTËRORE...



të merrte komandën e Ushtrisë së Tetë. Në orën 4 të mëngjesit, ai u bashkua me trenin e Ludendorffit në stacionin e Hanoverit, veshur me një uniformë të vjetër prusiane, veshja e vetme ushtarake që ai zotëronte. Brenda një jave, Ushtria e Tetë kishte fituar Betejën e Tannenbergut.

Hindenburg dhe Ludendorff do të ishin një palë e pandashme në komandën ushtarake dhe pushtetin politik gjatë katër viteve të ardhshme. Së bashku, ata ngritën fushatën e mëdha kundër rusëve dhe luftuan një luftë të gjatë dhe të zjarrtë të pushtetit kundër Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Erich

von Falkenhajni. Së bashku ata udhëhoqën Komandën e Lartë që zhvilloi përpjekjet e luftës gjermane nga rrëzimi i Falkenhajnit në gusht të vitit 1916 deri në rënien përfundimtare të Gjermanisë në vitin 1918. Megjithatë ishin të ndryshëm në sfondin shoqëror dhe kishin personalitete të kundërta, ato përputheshin në mënyrë të përkryer me qëndrimet dhe mendimet. Duke ardhur nga një shtresë e ulët shoqërore, Ludendorff e kishte bërë veten të respektuar dhe të papëlqyer për ambicjet e tij agresive dhe inteligjencën e pamëshirshme. Dinjiteti prusian i Hindenburgut dhe qetësia e paepur



ishin petëzimi i përsosur për energjinë dhe abrazivitetin nervor të Ludendorffit. Të dy burrat ndanin pikëpamjet tipike të nacionalistëve gjermanë. Hindenburgu ishte antisemit dhe i konsideronte socialistët - një pjesë e konsiderueshme e popullsisë gjermane - si një kërcënim potencial për përpjekjet e luftës. Ai mbështeti pastrimin e popullsisë sllave nga territoret rreth Baltikut dhe zëvendësimin e tyre nga kolonët gjermanë.

Ai hodhi poshtë nënshkrimin e paqes vetëm me përjashtim të kushteve që do të përfshiheshin në kontrollin e përhershëm gjerman: Franca verilindore dhe Belgjika dhe dominimi gjerman të Evropës Qendrore dhe Lindore. Në këto çështje Hindenburgu dhe Ludendorff ishin një. Në aspektin e imazhit publik, ishte Hindenburg i cili e zëvendësoi Kaiserin e lënë anash si qendër të patriotizmit të kohës së luftës. Ai u bë objekt i një kulti personaliteti, i cili u ushqye nga propagandistët gjermanë. Prej gushtit 1916, emri i tij u shtua në nisma të mëdha të tilla si Programi Hindenburg për të mobilizuar shoqërinë gjermane për luftë totale dhe linjën Hindenburg për fortifikimet përgjatë Frontit Perëndimor.

Ludendorfi përgjithësisht merrej me ushtrimin e vërtetë të fuqisë në partneritet me tij dhe Hindenburgun, qoftë në planifikimin dhe ekzekutimin e fushatave ushtarake apo në përcaktimin e politikës strategjike, por Hindenburgu ishte shumë më tepër se një njeri pasiv pas. Ai mori përgjegjësinë për të gjitha vendimet që përfundimisht çuan Gjermaninë në katastrofë, nga miratimi i luftës së pakufizuar të nëndetësive në vitin 1917 e deri tek në Ofensivat me



Hindenburgu kurrë nuk e humbi mbështetjen e popullit gjerman. Imazhi i tij si një ushtar i nderuar mbijetoi, ndërkohë që ndihmoi në zhvendosjen e fajit për humbjen e vendit tek socialistët dhe hebrenjtë, të cilët dyshohet se therën ushtrinë në shpinë

shkallë të gjerë të Pranverës në Frontin Perëndimor në vitin 1918. Ndërsa Ludendorff erdhi pranë krizës nervore pasi pozita gjermane u shpërbë në tetor 1918, Hindenburgu mbeti i qetë, duke mbështetur pranimin e një armëpushimi për shkak të mungesës së ndonjë alternative. Kur Ludendorff u detyrua të jepte dorëheqjen, Hindenburg qëndroi në detyrë duke shkaktuar një dëmtrim mes marrëdhënies së tyre që nuk la vend për rikuperimin e marrëdhënies së tyre të mëparshme 4 vjeçare. Në teori, një monarkist, por pa ndonjë respekt të madh personal për Kaiser Vilhelmin, ai kryesoi abdikimin e Kaiserit dhe kalimin në një republikë gjermane.

Hindenburgu kurrë nuk e humbi mbështetjen e popullit gjerman. Imazhi i tij si një ushtar i nderuar mbijetoi, ndërkohë që ndihmoi në zhvendosjen e fajit për humbjen e vendit tek socialistët dhe hebrenjtë, të cilët dyshohet se therën ushtrinë në shpinë. Pas luftës, ai u bind që të kthehej për herë të dytë në pension në 1925 për të qëndruar si kandidat i krahut të djathtë për presidencën e Republikës së Veimarit dhe u zgjodh. Popullariteti i qëndrueshëm i Hindenburgut siguroi mbajtjen e presidencës deri me vdekjen e tij në vitin 1934, duke mbikëqyruar rënien e qeverisë demokratike. Ai nuk e pëlqeu Adolf Hitlerin dhe e konsideronte një politikan të rrezikshëm socialist, por u bind që të emërojë udhëheqësin nazist në premtimin se ai mund të kontrollohej nga elita e vjetër. Në parim ai u bë urë midis Prusisë së vjetër dhe Rajhut të Tretë. Por pavarësisht kësaj njolle të zeze në biografinë e tij nuk mund të mohohet aspak fakti që ai ishte një nga figurat më të mëdha gjermane në Luftën e Parë Botërore por edhe në të gjithë historinë e Gjermanisë.



“Shqipëria nuk bëhet. Të pasurit nuk ndihmojnë, të varfrit nuk punojnë”...

Faik Konica njihet për gjuhën e tij të ashpër, si edhe për lëvizjet skajore në politikë, motivuar shpesh nga nevojat financiare. Letra e mëposhtme botuar nga DITA i përket Arkivit të Vjenës dhe mban datën 21 Nëntor 1897. Konica i shkruan i dëshpëruar kolegut të tij Visarion Dodani me të cilin ka korrespondencë të vijueshme. Konica ishte botues dhe drejtues i revistës “Albania”, Dodani botues dhe drejtues i revistës “Shqipëria”. “Shqipëria nuk bëhet - shkruan me revoltë Konica - të pasurit nuk ndihmojnë, të varfërit nuk punojnë”.

Bruksel, 21 Noëmbër 1897

I dashur vëlla Dodani,


Këndova me gas letërën tënde të dashur. Më pyet pse ndënjë aqë kohë pa u shkruar? Shkaku është se kam qënë në shumë trullime. Me të vërtetë kunjtoj tani se të huajtë paskan të drejtë: Shqiptarët s'janë të zotërit të marinë lirimin e tyre. Robër të poshtë nga 500 vjet e më shumë, robër për jetë do të mbeten. Unë faqeza t'a them: s'kam shpresë të bëhet kurë gjëkafshë, jam sigur se të gjithë ata që mendohen pakë, në mëndje t'ime janë. Që të kishim shpresa, duhej shqiptarët sot të kishin në një mijë vende komitete të shëndosha, të kishin propagandistë për të vajtur pshat më pshat nëpër tërë Shqipërinë, të kishin ditëtore dhe fleta në tërë viset e Evropës. Po s'kanë as gjëkafshë!

500 vjet robëri nuk i tundi pakë. Të pasurit s'ndihnen, të papasurit s'punojnë. Ç'presim ahëre? Për letrat ke të drejtë, por unë kam aqë mëkat për të shtypur fletët me ndihmën e tyreve të Stambollit; si t'a nxjer kur t'i zëmëronj edhe ata? Andaj punën e letrave do t'a lëshonj ende ca kohë, pastaj të hapim një “discussion”.

Të përqafoj vëllazërisht dhe mbetem vëllajyt,

Konitza

GJUHA SHQIPE ËSHTË SHKRUAR SHUMË KOHË PARA “MESHARIT”



Ana tjetër nuk është ndriçuar akoma nga drita e zbulimeve, prandaj, nisur nga hamendësime të ndërtuara në baza jo fort të qëndrueshme, Eqrem Çabej në librin “Shqipëria në Kapërcyell” paraqet disa hipoteza nga studiues të tjerë dhe jep edhe të reja nga vetë ai

I pari libër që dëshmon se edhe në shqip bëhej letërsi është “Meshari” i priftit shqiptar Dom Gjon Buzuku, i shkruar në shekullin XVI dhe i zbuluar e rizbuluar disa herë. Përveç kësaj vepre, monumentale për nga rëndësia historike, kemi edhe pak dëshmi të tjera të shqipes së shkruar si “Formula e Pagëzimit” nga Pal Ëngjëlli (1462), Fjalorthi i kalorësit gjerman Arnold von Harff (1497) dhe Ungjilli i pashkëvet pas rritit bizantin, i padatur saktësisht por i cili, sipas Çabejt, është mjaft i moçëm. Por kaq sa thamë më lart është vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër nuk është ndriçuar akoma nga drita e zbulimeve, prandaj, nisur nga hamendësime të ndërtuara në baza jo fort të qëndrueshme, Eqrem Çabej në librin “Shqipëria në Kapërcyell” paraqet disa hipoteza nga

studiues të tjerë dhe jep edhe të reja nga vetë ai.

Sipas tij, dokumentet e gjetura deri më sot nuk përjashtojnë mundësinë e ndonjë shkrimi shqip edhe më të vjetër. Kjo çështje mbetet gjithmonë e hapët e do shtruar vazhdimisht, për sa kohë arkivat italiane dhe sidomos ato të Vatikanit nuk janë shkundur plotësisht. Albanologu i madh Norbert Jokl, sipas Çabejt, duke u bazuar në të dhënat që vetë Buzuku jep në parathënien e veprës së tij, thotë se shqipja ka qënë e shkruar shumë kohë para këtij. Po sipas Çabejt, kushdo që ka lexuar këtë tekst disa herë me radhë, do të ketë të njëjtën përshtypje se gjuha e përdorur në të nuk është një arë fare e papunuar më parë. Studiuesi tjetër Petrotta, që gjithashtu përmendet nga Çabej, mendon se

në Shqipëri do të ketë pasur që përpara shekullit XVI një traditë ortografike dhe mbase edhe një gjuhë të përbashkët, së paku në shkrimet e përdorimit praktik. Një tjetër dëshmi vjen nga një prift anonim i cili, në vitet 1300, udhëtoi në Ballkan. Ai shkruan për shqiptarët se kishin një gjuhë të ndryshme nga ajo latine, greke dhe sllave me anë të së cilës nuk merreshin dot vesh me të tjerët. Por një ndër dëshmitë më të vlefshme është ajo e domenikanit frëng Brochart, pas emrit të të cilit fshihet ipeshkvi i Tivarit Gullielmus Adae. Ky shkruan për shqiptarët se këta, “ndonëse kanë një gjuhë krej më vete e ndryshe nga gjuha e Latinëve, megjithatë në marrëdhëniet e përditshme e në të gjithë librat e tyre përdorin shkronjat latine”. (*konica.al*)

NDËRROI JETË POETI BASRI ÇAPRIQI

Të dielën, një ditë pa mbushur 58 vjet, pas një sëmundjeje të rëndë ka vdekur poeti i njohur dhe profesori i Universitetit të Prishtinës, Basri Çapriqi

Çapriqi vuante nga një sëmundje e rëndë. Për një kohë është trajtuar në Turqi, ndërsa para pak ditësh është shtrirë në Spitalin Amerikan në Kosovë, ku edhe ka ndërruar jetë dje pasdite. I lindur më 15.01.1960, në Anë të Malit, Ulqin, Çapriqi ishte profesor i Letërsisë Shqipe, Gazetarisë, Letërsisë së Përgjithshme dhe Krahasimtare në Universitetin e Prishtinës. Ai ka lënë pas vetes gruan dhe dy fëmijë. Çapriqi

mbuar shkollimin e mesëm në Ulqin. Në Universitetin e Prishtinës ka studiuar letërsi shqipe, ku ka marrë gradën magjistër i shkencave filologjike në vitin 1988.

Në vitin 2004 merr gradën shkencore Ph. D. në Prishtinë në fushën e shkencave filologjike. Punoi profesor në Universitetin e Prishtinës, ku ligjëroi lëndët: Stilistikë, Semiologji dhe poezi bashkëkohore. Që në moshën stu-

dentore ai është bërë pjesë e botës së letrave dhe është dalluar si një krijues me një individualitet të vetin të qartë poetik. Shkroi poezi, kritikë letrare, ese, publicistikë. Ka botuar shtatë përmbledhje me poezi dhe pesë libra me kritikë letrare dhe studime. Librat më të njohur me poezi janë: “Ulli me dymijë unaza”, “Ma qet gjuhën”, “Frutat bizare”, “Zbutja e gjarprit”, “Përkryrja e shiut”. Librat me kritikë: “Mikrostruktura e tek-



stit”, “Simboli dhe rivalët e tij”, “Paradigma kadareane” etj. I ndjeri ishte një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ka qënë Kryetar i Bordit të Universitetit të Prishtinës, kurse nga viti 2012 ishte anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave. Ka udhëhequr PEN Qendrën e Kosovës, dhe ka botuar më

shumë se 100 studime e artikuj nëpër revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendi. Është përfshirë në dhjetra antologji të poezisë në gjuhë të huaja (polonisht, rumanisht, gjermanisht, kroatisht, maqedonisht, anglisht, frengjisht, arabisht, japonisht, koreane). Varrimi i të ndjerit do të bëhet të martën në Prishtinë.



U deklarua i vdekur, i burgosuri zgjohet në morg

Një i burgosur që u deklarua i vdekur nga tre mjekë, është zgjuar në morgun e spitalit. Ngjarja ka ndodhur në Spanjë në rajonin e Asturias. I burgosuri Gonzalo Montoya Jimenez u përmend pak orë përpara se t'i bëhej autopsia. Ai ishte deklaruar i vdekur nga tre mjekë me përvojë të burgut, të cilët urdhëruan që trupi i tij të dërgohej në morg për ekzaminim të mëtejshëm. Por aty i burgosuri u zgjua duke i habitur të gjithë. Autoritetet spitalore thanë për mediat se dyshohet që ky të jetë një rast i katalepsisë, që do të thotë se shenjat jetësore të një personi janë aq të ulëta dhe ngadalësohen deri në pikën kur janë pothuajse të padukshme. I burgosuri tashmë ndodhet nën kujdes intensiv në spital.

10 mijë euro gjobë për prindërit që publikojnë fotot e fëmijëve në rrjete sociale

Paralajmërohen prindërit. Baballarët dhe nënat që duan të publikojnë fotot e fëmijëve minorenë në "Facebook", "Twitter", "Instagram" dhe platforma të tjera sociale jo vetëm që do të detyrohen të heqin fotot por edhe duhet të paguajnë një gjobë. E çfarë gjobe se! Një masë prej 10 mijë eurosh. Kështu ka vendosur gjykata e Romës me një vendim të 23 dhjetorit 2017. Këtë lojë e ka hapur rasti i një djali 16-vjeçar që kërkoi mbrojtje kundër nënës së tij, e cila postonte foto dhe komente për të në web, raporton tgcom. Bëhet fjalë për një precedent unik në Itali për mbrojtjen e minorenëve, edhe pse janë shumë vendime që kanë detyruar prindërit të çaktivizojnë profilet sociale të fëmijëve ose të heqin fotot e publikuara në faqet e tyre. Dhe, përveç kësaj në vendimin e gjykatës së Romës, dispozitat që rregullojnë menaxhimin e imazhit të të miturve hyjnë gjithashtu në kushtet e ndarjes dhe të divorcit. Referenca ligjore që çoi në këtë vendim është në nenin 96 të ligjit mbi të drejtën e autorit, i cili parashikon që portreti i një personi nuk mund të ekspozohet pa pëlqimin e tij, përveç përjashtimeve. Për të mos përmendur që të miturit gëzojnë mbrojtje më të madhe të dhënë nga Neni 16 i Konventës së 1989 për të drejtat e fëmijës.

Burri ndërton 8 kilometra rrugë për shkak të fëmijëve të tij

Një burrë në një fshat të Indisë, ndërtoi një rrugë prej 8 kilometrash, vetëm me një sëpatë dhe një levë, kështu që fëmijët e tij që shkonin në shkollë, mund ta vizitonin atë më shpesh. Jalandhar Nayak 45 vjeç, jeton në një fshat të largët, 10 km nga shkolla ku studiojnë tre djemtë e tij. Por udhëtimi zgjat tre orë, sepse djemtë duhet të kalojnë nëpër pesë kodra për t'u kthyer në shtëpinë e tyre. Zyrtarët lokalë thanë për BBC se do të shtronin pjesën tjetër të rrugës. Cjatatë viteve të fundit, ai shkoi çdo mëngjes

me veglat e tij të punës, ku do të shpenzonte deri në tetë orë në ditë duke copëtuar shkëmbinj të dhe duke hequr gurët. Sipas BBC, burri tha se shpresonte që djemtë e tij do të ishin në gjendje të ktheheshin në shtëpi më shpesh gjatë fundjavave apo festave sapo të përfundonte rruga. Rruga prej 15 km e gjatë do të lidhë fshatin e Nayakut në qytetin ku gjendet shkolla. Zyrtarët qeveritarë, të cilët tani kanë marrë përsipër ndërtimin, thanë se z. Nayak do të paguhej gjithashtu për punën e bërë.



BRITANIA E MADHE I HAP LUFTË GOTAVE NJËPËRDORIMËSHE TË KAFESË



Një grup deputetësh britanikë propozuan këtë të premte të taksonin qindra miliona gota letre njëpërdorimshe që prodhohen çdo vit në vend dhe që këto

para të shkojnë për përmirësimin e riciklimit të tyre. Anëtarët e komisionit parlamentar për mjedisin i sugjeruan qeverisë që përdoruesit të paguajnë 25 peni për

gotë (28 cent të euros ose 34 cent të dollarit), një taksë që është emëruar si "taksë late" (latte levy), nga emri i kafesë me qumësht. "Çdo vit përdoren 2.500 milionë gota në Mbretërinë e Bashkuar, mjaftueshëm sa për të mbështjellë tokën 5 herë, e asnjë prej tyre nuk riciklohet", sqaroi presidentja e këtij komisioni, deputetja Mary Creagh. Fondet e mbledhura do të shërbejnë për qëllimin e riciklimit të të gjithë këtyre gotave para vitit 2023. Nëse kjo gjë nuk realizohet deputetët besojnë se qeveria duhet të ndalojë këto gota. Gjithashtu deputetët thonë se ata prodhues që përziejnë letrën me plastikën duhet të paguajnë më shumë. Disa kompani zinxhir të kafesë po merren me këtë problem dhe ofrojnë zbritje për ata klientë që sjellin vetë gotat e tyre. Starbucks ofron një zbritje prej 50 penish, por kjo nuk ka ndryshuar gjërat, pasi vetëm 1.8% e klientëve të tij sjellin gotën e vet.

Njeriu "ujk" nga Turqia: Berberi publikon videon që ka shokuar botën

Për vetëm 4 ditë, kjo video është shikuar nga 1,4 milion njerëz. Berat Polatoglu, berber nga Diyarbakir i Turqisë, ka publikuar një video në profilin e tij në Instagram një video të shkurtë ku ka gjiruar qimet në shpinën e një klienti të tij. Janë bërë vetëm 4 ditë nga dita kur e ka publikuar dhe këtë video e kanë shikuar 1,4 milion njerëz deri më tani. Djali i cili shihet në video e ka shpinën dhe trupin të mbushur me qime të zeza dhe të dendura. Barati pasi që ia ka hequr qimet e tepërta, në ato qime mund të bëj çfarëdo



modeli që dëshiron, transmeton gazetatametro.net. Të pasurit qime të tepruar

në trup mund të jetë edhe sëmundje, e cila ndryshe quhet Hipertrikoza.

Kinezi më i pasur në botë: Isha më i lumtur kur fitoja 12 dollarë në muaj

Jack Ma, themeluesi i kompanisë Alibaba, është kinezi më i pasur dhe një ndër njerëzit më të pasur në botë. Ai 'peshon' 25 miliardë dollarë. Megjithatë, Ma thotë që ishte i lumtur - madje më i lumtur se tash - kur ishte mësues anglishteje në një universitet në Kinë dhe fitonte 12 dollarë në muaj. Me këtë punë ai kishte jetuar pas diplomimit

më 1988 në Hangzhou të Kinës. Ai thotë që arsye për këtë është fakti që me pasurinë e madhe vjen edhe niveli i njëjtë i përgjegjësisë, që nuk ekziston kur nuk paguheni shumë. Periudhën kur është paguar fare pak ai e përshkruan si më të lumturën në jetën e tij, kurse thotë që kur mblodhi pasuri prej 10 milionë dollarësh, bashkë me

to erdhën edhe telashet. "Nëse keni më pak se 1 milion dollarë, ju e dini se si t'i shpenzoni, ndërsa kur bëheni miliardar - ato më nuk janë vetëm paratë tuaja. Paratë që kam sot janë përgjegjësi, është besimi i njerëzve ndaj meje", thotë Ma, që udhëheq kompaninë Alibaba, ndër më të suksesshmet në botë.



RUDI VATA FLET PËR ZGJEDHJET NË FSHF

Edhe po të ishte Iglj Tare kandidat potencial kundër Dukës, të jap garanci të plotë që nëse ai nuk do të merrte 'OK' in e qeverisë dhe politikës, e garantuar që nuk do të fitonte. Ndonëse ka bërë shumë gjëra të mira dhe po bën shumë gjëra të mira, në Shqipëri do të dështonte", pohon Vata



DO TË JETË LUFTË SHITBLERJESH, EDHE TARE DO TË DËSHTONTE

Më 7 shkurt mbahen zgjedhjet për presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit, ndërsa në garë do të jenë kryetari i deritashëm, Armand Duka dhe deputeti Bashkim Fino. Njëri ndër shqiptarët me karrierë të suksesshme në Evropë, që kishte provuar rikthimin për të kontribuar në Shqipëri, Rudi Vata, që kishte kandiduar kundër Dukës në zgjedhjet e 4 viteve më parë. "Sigurisht që ka për të qenë një

luftë e ashpër monetare sepse ju e dini që në Shqipëri asgjë nuk është e ndërtuar mbi baza të shëndosha profesionale dhe morale. Kështu që do të jetë luftë blerjesh, luftë shitjesh dhe ka për të pasur tradhti e pabesi", ka thënë Vata për "Panoramën". Në pyetjen se a ka prituri që në këtë garë të kishte edhe kandidatë të tjerë potencialë Vata është përgjigjur: "Edhe po të ishte Iglj Tare kandidat potencial kundër

Dukës, të jap garanci të plotë që nëse ai nuk do të merrte 'OK' in e qeverisë dhe politikës, e garantuar që nuk do të fitonte. Ndonëse ka bërë shumë gjëra të mira dhe po bën shumë gjëra të mira, në Shqipëri do të dështonte. Si emër, si njeri i futbollit, me kontributin që ka dhënë dhe me eksperiencën që ka, do të dilte njeri pa vlera në Shqipëri", ka thënë ai. "Unë nuk di se kush tjetër mund ta merrte për-

sipër ose mund të kishte forcën e karakterit dhe forcën e besimit të dilte. Në Shqipëri, po nuk je i fortë psikologjikisht, fizikisht dhe ekonomikisht dhe me mbështetje politike, e ke të kotë të harxhosh kohën. Mua më vjen keq vetëm për kohën dhe energjinë që kam harxhuar, por më vjen shumë mirë se e kam kuptuar që në Shqipëri ishte një kasaphanë e paparë", përfundoi Vata.

Ademi shënon në fitoren e thellë të Dinamos

Shkup, 15 janar - Futbollistët e Dinamo Zagrebit në kuadër të përgatitjeve dimërore zhvilluan edhe ndeshjen e parë kontrolluese në Rovinj. Djemtë e trajnerit Cvitanović shënuan fitoren të thellë 5-0 ndaj seleksionit të Istra. Ndryshe, në mesin e golashënuesve u gjend edhe futbollisti shqiptar Arijan Ademi, i cili shënoi golin e dytë, ndërsa golat tjerë u shënuan nga Sosa, Soudani dhe në dy herë Fiolli. Golin, Ademi i cili ishte edhe kapiten i skuadrës, e shënoi me

kokë pas asistimit të Soudanit. Ndërkohë, Ademi luajti titullar, kurse në njëmbëdhjetëshin e parë u gjend edhe kosovari Rahmani. Pas kësaj ndeshje, Dinamo rikthehet në Zagreb, ndërsa futbollistët do të kenë dy ditë pushim, kurse të mërkurën në mëngjes do të udhëtojnë në Belek të Turqisë, ku do të qëndrojnë deri më 31 janar. Nga klubi njoftojnë se për fazën e dytë të përgatitjeve janë planifikuar edhe disa ndeshje kontrolluese. (B.K.)



DËMTOHET DA SILVA

Shans për Sadikun



Nga një lojtar në rrugën e largimit, në alternativën e vetme të vlefshme. Situata e Armando Sadikut te Legia e Varshavës ndryshoi plotësisht në harkun e pak orëve. Shkak u bë miqësorja me ekuadorianët e Barcelonës, në turneun "Florida Cup 2018", që po zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Blerja e bujshme e Legias, sulmuesi Eduardo Da Silva, u dëmtua në debutim, me situatën e ish-lojtarit të Arsenalit dhe përfaqësueses së Kroacisë që sipas mjekëve është mjaft serioze. Lëndimi i 34-vjeçarit ishte një shans për Armando Sadikun që zbriti në fushë në pjesën e dytë të miqësore

dhe ishte protagonist në të gjitha manovrat ofensive të skuadrës më të madhe polake. Me ekipin që në 45 minutat e para po humbiste 3-1, aktivizimi i sulmuesit kuqezi i dha një impuls të ri lojës, me Legian që shkurttoi shifrat në 3-2, e megjithatë në fund nuk arriti të evitonte humbjen. Pavarësisht rezultatit, paraqitja e Sadikut confirmoi atë që presidenti i klubit nga Varshava kishte thënë pak ditë më parë: që pavarësisht konkurrencës së fortë, "bomberi" shqiptar nuk ka ndërmend të dorëzohet dhe do të luftojë për vendin e tij në formacion, në sezonin ku Legia pretendon të rikthehet te titulli kampion.



Llullaku largohet nga Astana

Sulmuesi shqiptar, Azdren Llullaku, ka njoftuar në "Instagram" se ka ndërprerë kontratën me klubin aktual nga Kazakistani, Astana. Aventura e Llullakut me Astanën duket se nuk ka përfunduar mirë. Ai luajti pjesën e dytë të sezonit të kaluar me ta, duke shënuar vetëm një gol, ndërsa këtë sezon ka qenë i huazuar te Tobol. "Sot mbylla aventurën time me Astanën. Dua të falënderoj tifozët, klubin, lojtarët dhe këdo që e do Astanën dhe punon për të. Paçi fat të gjithë", shkruan Llullaku. Ndërsa, në të njëjtën ditë ai ka postuar një tjetër foto, ku shfaqet në avion duke u larguar nga Kazakistani. Gjithashtu zbuloi edhe destinacionin e tij të radhës, që është Stambolli. Nuk dihet nëse Llullaku po shkon në Stamboll, për të firmosur me ndonjë ekip të kryeqytetit turk, apo për arsye personale.

Kosova siguron miqësoren e radhës

Përfaqësuesja e Kosovës do të zhvillojë miqësoren e radhës. Siç konfirmon vetë FFK në faqen zyrtare të saj, Kosova do të përballlet me Azerbajxhanin. Ndesha do të zhvillohet në Antalia me datë 2 shkurt. Federatat kanë arritur marrëveshjen midis tyre. "Federata e Futbollit e Kosovës ka arritur një marrëveshje me Federatën e Futbollit të Azerbajxhanit, e cila marrëveshje pritet të nënshkruhet nesër, e me të cilën është paraparë që më 2 shkurt në Antalia të Turqisë ta zhvillojnë një ndeshje miqësore ndërmjet dy kombëtareve. Ndërkaq, që Kombëtarja A e Kosovës do të përbëhet prej futbollistëve të Vala Superligës që do të jetë një test i mirë për të parë cilësitë e futbollistëve vendor", mbyll FFK.



JUPP HEJNKES FLET PËR MERKATON E BAVAREZËVE

PËR DE BRYNEN DO TË JEPJA GJITHÇKA



"Kevin De Bryne i këtij sezoni nuk ka lidhje me atë të vitit të kaluar, por për të unë do të jepja gjithçka vetëm për të pasur në radhët e Bajernit. Momentalisht është një prej lojtarëve më të mirë në Evropë. Është i nevojshëm afrimi i ndonjë futbollisti, por në ditët e sotme me 50 milionë euro është disi e vështirë të sigurosh elementë cilësorë", u shpreh Heynkes



Jupp Heynkes i fiksuar pas Kevin De Bryne. Trajneri i Bajernit të Munihut ka folur për merkaton e bavarezëve dhe në veçanti për mesfushorin e Manchester Siti për të cilin është i gatshëm të bëjë çdo vetëm për të pasur në dispozicion shërbimet e lojtarit. "Kevin De Bryne i këtij sezoni nuk ka lidhje me atë të vitit të kaluar, por për të unë do të jepja gjithçka vetëm për të pasur në

radhët e Bajernit. Momentalisht është një prej lojtarëve më të mirë në Evropë. Është i nevojshëm afrimi i ndonjë futbollisti, por në ditët e sotme me 50 milionë euro është disi e vështirë të sigurosh elementë cilësorë", u shpreh Heynkes.

Fjalët e gjermanit janë një mesazh i qartë që belgu është nën lupën e tij. Për momentin vështirë se mund të flitet për një tran-

sferim të mundshëm, por ndoshta në verë dëshira mund të jetë më konkrete. Më pas Heynkes flet për suksesin e trefishtë. Arritje kjo që kampionët në fuqi të Gjermanisë e kanë siguruar më herët pikërisht gjatë kohës kur drejtoreshin nga 72-vjeçari. "Jemi favoritë, por sigurisht gara është e fortë. Ka skuadra si Manchester Siti, Reali i Madridit, Paris Sen Zhermen dhe Barcelona të cilat janë

kundërshtarë të fortë. Është e vështirë të sigurosh sukses të trefishtë, kampionat, 'Champions League' dhe Kupën e Gjermanisë, por ne do ta provojmë. I kemi të gjitha mundësitë. Personalisht dua kampionatin. Do të ishte sukses i madh, sepse të marrësh në gjysmën e sezonit skuadrën dhe të fitosh kampionatin nuk është mision i thjeshtë", përfundoi trajneri i Bajernit.



Milani bllokon largimin e Susos

Sa vlen Jesus Suso? Kjo është pyetje e madhe, sepse spanjoli, pas disa muajsh, mund të bëhet një mundësi e mirë për të gjitha klubet në Evropë. Liverpool, që e ka arkën plot pas largimit të Kutinjos te Barcelona, kërkon një futbollist për ta zëvendësuar dhe ka identifikuar sulmuesin e Milan si lojtarin e duhur. Nga ana tjetër klubi kuqez i nuk ka ndërmend ta largojë pa marrë të paktën 80 milionë euro, çmimi i caktuar nga Mirabelli dhe Fassone. Në momentin e rinovimit të kontratës, që daton në shtator 2017, Milan dhe Suso kanë përfshirë një klauzolë për prishjen e kontratës prej 40 milionë eurosh, 50 milionë euro nëse Milan shkon në Çampions Ligë. Kjo e lejon spanjollin të largohet në çdo moment, pa marrë lejen e klubit, nëse dikush paguan klauzolën. Në këto kushte, 80 milionë euro që Milan kërkon sot nuk paguhen nga askush, por në verë do të ketë një mal me klube që do të jenë gati të paguajnë 40 milionë. Milan mendon se mund të arrijë ende në Çampions Ligë, edhe në rast të një suksesi në Liga Evropë dhe nuk ka ndërmend të dobësojë përbërjen e ekipit të drejtuar nga Gattuso, por nëse nuk ia del atëherë verën e ardhshme do të jetë i detyruar të shesë dhe në bazë të kontratës Suso do të kushtojë 40 milionë euro. Pra, spanjollin mund të transferohet gjatë merkatos së verës, teksa mbetet ende për t'u parë se çfarë do të ndodhë me Donnarumma.

Kannavaro i ofron Romës 50 mln për Nainggolan



Merkatoja e Romës mund të përjetojë një zbulim të papritur. Së pari dhe pastaj, me sa duket, edhe në hyrje. Shkëndija për të cilën po flasim e sheh Raxha Nainggolan si protagonist, i cili nuk po kalon momentin e tij më të mirë, as si pjesë e ekipit, as si individ, nën hijen e "Colosseo". Mesfushori i Romës, sipas

"Gazzetta dello Sport", në fakt është emri i parë në listën e merkatos së Fabio Kannavaro. Trajneri italian i Guangzhou Evergrande e telefonoi personalisht Eusebio Di Françeskon, si dhe lojtarin, duke shpjeguar të gjitha planet e tij. Pastaj, vetë klubi kinez vazhdoi të "sulmonte" atë italian. Oferta e Evergrande Guangzhou është 50 milionë euro dhe vetë lojtari pritet të përfitojë mbi 12 milionë euro. Problemi më i madh është ai i zakonshëm dhe ka të bëjë me tatimin, që Federata Kineze e Futbollit ka imponuar për transfertat

nga jashtë, që i tejkalojnë 6 milionë. Në praktikë, klubi në fjalë duhet të paguajë tepërcën (në këtë rast 44 milionë) në formën e investimeve për zhvillimin e futbollit të rinjve kinezë. Pra, shpenzimet totale do të arrijnë në 94 milionë. Një situatë që, padyshim, Guangzhou e di dhe është e gatshme të përballet. Situata, ndër të tjera, ka vazhduar për rreth një vit. Në këtë moment, gjithsesi, gjithçka mbetet në pritje, edhe nëse nuk ka kohë për të humbur, pasi Roma do të duhet të shkojë në "gjueti" për zëvendësuesin.

Kur shkova te Reali, qava deri në aeroport

Majkell Ouen ishte një nga emblemat e Liverpoolit kur u largua nga "Anfield" në vitin 2004 për te Real Madridi. Ai kishte debutuar në moshën 17-vjeçare dhe mori "Topin e Artë" në vitin 2001. Ishte në rrugën e tij për t'u bërë një legjendë te "Reds", por interesi i Real Madridit bëri që të merrte vendimin për t'u larguar. Një vendim që nuk ishte i lehtë për Ouen dhe se, sipas një artikulli të botuar në "Sunday Mail", krahasohet me mënyrën e largimit të Kutinjos.


"Unë vendosa për t'u larguar, por kam qarë pothuajse gjithë rrugën, nga shtëpia ime deri në aeroport. Një pjesë e imja nuk donte të largohet. Duke gjykuar nga fotot e rrugës së Filip Kutinjo drejt Barcelonës, javën e kaluar, besoj se ai nuk ndihej në të njëjtën mënyrë", shkruan Ouen, duke i krahasuar kujtimet e tij me imazhin e freskët të brazilianit. Ish-ndërkombëtar i anglez pranon se, pavarësisht vështirësisë që iu desh për ta marrë këtë vendim, ka qenë aq i sukses-

shëm në atë kohë. "Kur Real Madridi u interesua për mua, në vitin 2004, një pjesë e imja u kënaq, sepse bëhej fjalë për një ekip ku luanin Zidane, Ral, Bekam, Ronaldo, Roberto Karlos dhe Luis Figo, por koka ime vazhdonte të rrotullohej te Liverpool", kujton ai. Ouen, i cili kaloi vetëm një sezon te Reali, shpjegon: "Po të kisha qëndruar te Liverpooli gjithë karrierën time, mund të kisha pasur një karrierë fantastike si Steven Xherrard dhe Xhimi Karrager", përfundoi Ouen.





• Dmytro Çigrinski




• Aleks Song




• Aleks Hleb




• Kerrison



• Emmanuel Petit



• Xheovanni



• Fabio Roçembak

TURAN DHE 15 BLERJET MË TË DËSHTUARA

Arda Turan mbërriti për 34 mln euro nga Atletico Madrid por duhet të priste gjashtë muaj të aktivizohet pasi katalanasit ishin pezulluar nga FIFA. 30-vjeçari bëri vetëm 55 paraqitje, secila i ka kushtuar klubit 1 mln euro nëse do t'i shtonim rrogën shumë të paguar nga Barcelona. Këtë sezon nuk luajti asnjë ndeshje të vetme dhe si përfundim u rikthye në vendlindje.

DMYTRO ÇIGRINSKI

Një blerje e çuditshme e Barcelonas në 2009, Çigrinski kaloi vetëm një sezon te katalanasit, dhe ishte një sezon zhgënjyes për ukrainasin. Barça pagoi 25 mln euro për qendërmbrojtësin dhe ndeshja e tij e fundit ishte finalja e humbur e superkupës kundër klubit katalanas që iu bashkua më vonë. Ai bëri vetëm 14 dhe u shit 15 mln euro te Shakhtar në 2010 – megjithëse Pep Guardiola donte që ai të qëndronte.

ALEKS SONG

Në verën e 2012, Barcelona ishte në kërkim të një lojtari që operonte mes mbrojtjes dhe mesfushës, por që mund të luante edhe qendërmbrojtës. Dhe pasi nuk donte të shpenzonte 40 mln euro për Havi Martinez i cili shkoi te Bajerni, Barça mori Aleks Song nga Arsenal. Gjithsesi ai ishte një dështim pasi nuk i përshtatej lojës së katalanasve. Pas dy sezoneve ai u largua për te Uest Hem.

ALEKS HLEB

Hleb iu bashkua Barças për 17 mln euro në 2008 megjithëse bëri shumë paraqitje me ekipin e parë për klubin, ai nuk luajti ndonjë rol të rëndësishëm në vitin e tripletës. Mesfushori bjellorus shkëlqeu te tre sezonet e luajtura tek Arsenal, por 36 paraqitjet e tij te Barça u harruan shumë shpejt. Më pas ai shkoi te Shtutgart, Birmingham dhe Wolfsburg.

KERRISON

Kerrison iu bashkua Barcelonas nga Palmeiras për 14 mln euro në 2009, por sulmuesi nuk arriti të bënte një paraqitje të vetme nga minuta e parë për klubin. Sulmuesi më pas u huazua te Benfika, përpara se të kalonte periudha te Fiorentina, Santos, Cruzeiro dhe Kortiba. Në 2014 ai u largua nga Barça dhe aktualisht luan për Londrina në vendlindje.

EMMANUEL PETIT

Emmanuel Petit ishte një sukses i madh tek Arsenal i Arsën Venger, por ai nuk u përshtat siç duhet te Barcelona pas kalimit të tij me vlerë 14 mln euro. Francezi iu bashkua katalanasve bashkë me Mark Overmars në 2000, por e ka cilësuar si gabimin më të madh të karrierës kalimin në Spanjë, duke pretenduar se nuk merrte vesh as pozicionin që duhet të luante te Barça. Edhe pas largimit një sezon më pas, ai nuk ishte më i njëjti as te Çells.

XHEOVANNI

Shumë brazilianë fantastikë kanë luajtur te Barcelona gjatë historisë së klubit por Xheovanni nuk arriti të përmendej në të njëjtën fjalë me Ronaldo, Rivaldo, Ronaldinjo apo Nejmar. Si një rekrut 18 mln euro nga Cruzeiro në 2001, mesfushori i avancuar bëri 50 paraqitje në dy sezona por nuk bindi dhe si pasojë u shkarkua te Benfika. Më pas ai luajti edhe te Mançester Siti dhe Hull në Premier Ligë.

FABIO ROÇEMBAK

Braziliani Roçembak u ble nga Barça për të zë-

vendësuar Pep Guardiola-n, pra pritshmëria ishte shumë e madhe për të. Ai as që nuk iu afrua. Paraqitjet e tij ishin zhgënjyese dhe ai ishte shumë larg nivelit të Pep, i cili ishte transferuar te Breshia. Si pasojë Roçembak u largua për te Sporting, përpara se të kalonte tre sezona te Midwllzboro në 2005.

HENRIQUE

Henrique ishte pjesë e klubit nga 2008 deri 2012, periudha më e suksesshme e historisë së klubit teksa fitoi 14 trofe nga 19-të mundshmit nën drejtimin e Pep Guardiolas. Gjithsesi qendërmbrojtësi i blerë 8 mln euro nga Palmeiras nuk pati asnjë ndikim. Ai nuk bëri asnjë paraqitje përpara se të huazohej tri herë radhazi te Leverkusen, Rasing Santander dhe Palmeiras. Aktualisht ai luan te Fluminense.

VITOR BAIA

Baia konsiderohej një nga portierët më të mirë të Portos, por ai kishte dy sezona problematike midis 1996 dhe 1998 pas transferimit 6.5 mln euro. Disa gabime në sezonin e parë bënë që Van Gaal të humbte besim tek ai. Në verën e 1998 ai u rikthye te Porto dhe arriti të fitonte disa tituj të tjerë në Portugali – duke përfshirë Çampions Ligë në 2003/04 nën drejtimin e Mourinjós.

FILIP KRISTANVAL

Një blerje 6.5 mln euro nga Monako në verën e 2001, Kristanval nuk bëri asnjë impakt në "Camp Nou" për skuadrën që bënte tifo që i vogël. Dy vite te Barça, qendërmbrojtësi francez nuk mundi të bëhej një titullar de iu bashkua Marsejën në 2003. Pas shumë vështirësive në vazhdim, ai i dha fund karrierës në moshën 31-vjeçare.

KRISTOF DUGARRI

Barça bleu Dugarri nga AC Milan në një marrëveshje të dyfishtë bashkë me Reiziger për 9 mln euro. Dhe teksa mbrojtësi pati një karrierë të suksesshme duke kryer 200 paraqitje me klubin, sulmuesi francez luajti vetëm shtatë ndeshje për katalanasit. Ai dështoi kompletisht nën drejtimin e Van Gaal dhe nuk shënoi asnjë gol të vetëm me fanellën e katalanasve.

DAGLAS

Daglas iu bashkua Barças në verën e 2014 për 4 mln euro nga Sao Paulo, por ai kreu vetëm tetë paraqitje në dy sezona dhe është tallur jashtë mase pas një debutimi të turpshëm ndaj Malagas në La Liga. Pas asaj ndeshjeje, ai kryesisht është përdorur në "Copa del Rey". Aktualisht është duke luajtur te Benfika.

EMMANUEL AMUNIKE


Pjesë e Nigerisë që shkëlqeu në Kupën e Botës në 1994, Amunike u transferua te Barcelona dhe qëndroi për katër vite. Por ai bëri shumë pak paraqitje pasi pësoi një dëmtim serioz në 1997. Në fund ai shkoi te Albasete në 2000, përpara se të luante në Korenë e Jugut dhe Jordani.

RUSHTU REÇBER

Barcelona e mori me parametra zero portierin nga Fenerbahçe në 2003, por portieri turk nuk arriti të mësonte spanjishten dhe si pasojë u la jashtë skuadrës. Trajneri Rajkaard zgjidhte të riun Valdez në vend të tij dhe turku ankohej në media se një lojtar i reputacionit të tij meritonte të luante në formacion. Por teksa Valdes eventualisht arriti të bëhej një nga portierët më të mirë të historisë së klubit, Rushtu bëri vetëm shtatë paraqitje përpara se të rikthehej te Fenerbahçe.



• Henrique




• Vitor Baia




• Filip Kristanval




• Kristof Dugarri



• Daglas



• Emmanuel Amunike



• Rushtu Reçber

Teksa mesfushori turk u transferua në vendlindjen e tij, le t'i hedhim një sy blerjeve më të dështuara të historisë së katalanasve

KRISTIANO RONALDO DREJT LARGIMIT

JA “KRYENGRITJET” E TJERA TË PORTUGEZIT NDAJ PEREZIT

Kjo nuk është hera e parë që ylli portugez kërcënon me mundësinë e largimit. Ai e ka bërë këtë edhe në vitin 2012 dhe 2015, por më në fund rinovoi në vitin 2013, si dhe në vitin 2016. Këto më poshtë janë rastet e zemërimit të tij me presidentin Florentino Perez.

Kristiano Ronaldo dëshiron të largohet nga Madridi. Ai ndjehet i mashtruar nga premtimet e rinovimit, që nuk i ka përmbushur mjaftueshëm Florentino Perez. Tani prioriteti i tij është përqendruar në rikthimin te Mançester Junajted. Portugezi konsideron se “Old Trafford” është stacioni ideal për të vazhduar udhëtimin e tij. Në klubin anglez, ku ai luajti nga viti 2003 deri në nënshkrimin me Real Madridin, në vitin 2009, dhe me të cilin fitoi “Topin e Artë”, tashmë e dinë dëshirën e tij. Vendimi i yllit portugez është aq i fortë, sa ua ka komunikuar disa shokëve të skuadrës te “Los Blancos”. Pavarësisht se është golashënuesi më i mirë në historinë e klubit madrilen, kristiano Ronaldo nuk ka pasur ndjenja të mira me Perez dhe ka hasur gjithmonë vështirësi, kur ka negociuar rinovimin. Portugezi ka fituar tre nga katër “Topat e Artë” të fundit, pesë në total, po aq sa Messi. Megjithatë, kjo nuk e ka ndihmuar atë të jetë një nga tre më të paguarit në botë. Për më tepër, në renditjen e lojtarëve me paga më të mira, Ronaldo renditet i pesti me 21 milionë euro në sezon, neto, pas rinovimit të saj të fundit, që daton nga nëntori 2016. Por, kjo shifër është larg nga ajo që merr Messin dhe Nejmar. Sidoqoftë, kjo nuk është hera e parë që ylli portugez kërcënon me mundësinë e largimit. Ai e ka bërë këtë edhe në vitin 2012 dhe 2015, por më në fund rinovoi në vitin 2013, si dhe në vitin 2016. Këto më poshtë janë rastet e zemërimit të tij me presidentin Florentino Perez.

I NGEÇUR MË 2012

“Jam i trishtuar”, – tha ai në vitin 2012. Ai filloi sezonin e tij të katërt, pa pasur ndonjë përmirësim të pagës (te Mançester Junajted kishte pesë rishikime në gjashtë vjet). Ai i tregoi Florentino Perezit se nuk i pëlqente të shkonte në garën e UEFA-s pa e shoqëruar atë, ndërkohë që pa Messin dhe Iniestën me Rosellin. “Nëse largoheni, sill paratë për të nënshkruar Messin”, – ishte përgjigja e presidentit. Ditën tjetër, ai shënoi dy gola kundër Granadës dhe nuk i festoi ato. “Unë jam i trishtuar dhe në klub e dinë këtë gjë”, – tha ai.

RINOVIMI MË 2013

Një vit tërheqjeje lufte. Kristiano Ronaldo qëndroi një sezon pa konfirmuar nëse e kishite rifituar lumturinë. PSZH-ja ofroi 200 milionë euro. Emri i Nejmar u filtrua sérish si zëvendësues i tij. “Nuk ka negociata për të



ripërtërirë kontratën”, – tha Florentino Perez në qershor 2013, i cili gjendej para nënshkrimit të Bale (101 milionë €). Por, më pas u mbyll rinovimi i KR7 deri në vitin 2018, kur dallimet në pagesë ishin të konsiderueshme.

I NGEÇUR MË 2015

Thirrja i erdhi nga Al-Khelaifi. 2 nëntor 2015. “Të largohem nga Real Madridi? Pse jo?” – komentoi futbollisti në “Kicker”. Pastaj ai pati një përhëndetje të ngrohtë me Al-Khelaifi, që shërbeu për të nxitur thashethemet. Deri në përhëndetjen e futbollistit me Loren Blan, që sipas “Parisien” ishte e tillë: “Do të doja të luaja me ju”. “Radio Montecarlo” njoftoi një darkë midis presidentit të PSG-së dhe Jorge Mendes.

RINOVIMI NË VITIN 2016

Ashtu si herën e parë, distancat mes palëve dukeshin të pakapërcyeshme. Aq më shumë nëse kihet parasysh se sezoni filloi me Rafa Benítez trajner. Marrëdhënia e tyre filloi keq. Trajneri erdhi duke dashur të kënaqte presidentin dhe për këtë, një nga vendimet e tij të para ishte të shkonte për të parë Bale me kombëtaren e Uellsit në Kardif. Një nderim që nuk e kishte CR7. Ai e dinte se klubi donte të peshonte figurën e uellsianit mbi të tijën. Për fat të mirë për Real Madridin dhe Ronaldon, Zidan zëvendësoi trajnerin e sotëm të Njukasëll sot. “Ai duhet ta përfundojë karrierën e tij këtu”, – tha francezi sapo ai arriti. Disa muaj më vonë, në nëntor 2016, mrekullia ndodhi dhe rinovimi me portugezin u bë deri në vitin 2021.

I BEZDISUR MË 2017

Probleme me Thesarin. Në qershor të vitit 2017, “A Bola” nxori në pah se Kristiano Ronaldo donte të largohej nga Spanja. Pas kësaj ishte pakënaqësia e tij lidhur me çështjen e mashtrimit të pretenduar të taksave. Lojtari nuk e mohoi atë informacion. Për më tepër, deklarata e tij u zbulua teksa fliste para gjyqtarit të çështjes, gjë që “AS” e avancoi të hënën vijuese: “Unë kurrë nuk kam pasur probleme në Angli, prandaj do të doja të kthehesha atje...” Më 2 nëntor 2017, ai i tha shtypit: “Nuk dua të rinovoj me Real Madridin”. Pastaj, pas Botërorit të Klubeve në Abu Dabi, ai e zbuti mesazhin: “Dua të dal në pension këtu, por presidenti është shefi...”

RINOVIMI APO LAMTUMIRË NË VITIN 2018?

Më 14 janar 2018, Kristiano Ronaldo dëshiron të largohet nga Real Madridi. Dhe presidenti Perez është duke marrë të njëjtin pozicion, si në fërkimet e mëparshme. Zërat mediatikë nga Spanja thonë se klubi dëshiron Neymar dhe ofron si pjesë të operacionit vetë Kristiano Ronaldon. Pikërisht, ky interes dhe flirtin me PSG-në i yllit brazilian e shqetëson Kristianon, sidomos. Mbetet të shohim se si do të përfundojë kjo “soap opera”: me një tjetër rinovim dhe kënaqje e futbollistit “të persekutuar” për një kohë të gjatë, apo me lamtumirën e afërt, e cila ndoshta e bën portugezin lojtari më të paguar në historinë e futbollit.

LAJME SHKURT

Debushi lë Arsenalin

E ardhmja e Matiu Debushi mund të jetë larg Premier Ligës. Mbrojtësi i krahut të djathtë të Arsenalit, skuadër tek e cila është transferuar që në vitin 2014, nuk po gjen vend në formacionin e Arsen Venger dhe për këtë mund të vendosë të largohet që gjatë kësaj merkatoje. Me shumë mundësi 32-vjeçari do të rikthehet në Ligue 1, ku skuadra e Sent-Etienne, që drejtohet nga Zhan-Luis Gasset ka shfaqur interes për të.

Giggs, trajneri i ri i Uellsit

Rajan Giggs është trajneri i ri i përfaqësueses së Uellsit. Mungon vetëm zyrtarizimi i cili do të vijë në orët e ardhshme por tashmë është e sigurt që ish mesfushori legjendar i Mançester Junajtedit do të ulet në stolin e kombëtares së vendit të tij për të udhëhequr Uellsin drejt kualifikimit në Euro 2020 dhe Botërorin 2022. Giggs do të firmosë një kontratë 4-vjeçare me përfaqësuesen nga Mbretëria e Bashkuar dhe do të mundohet ta çojë sa më larg Uellsin duke marrë më të mirën nga yjet e skuadrës Geret Bejll dhe Aron Ramsey, gjatë kësaj periudhe. Ai zëvendëson në këtë detyrë të larguarin Kris Coleman.

Babakar kërkon largimin

Khouma Babakar vijon të jetë një nga emrat më të lakuar në merkaton e Janarit, në Serinë A dhe jo vetëm. Sulmuesi i Fiorentinës nuk pranon të rinovojë dhe kërkon të luaj rregullisht, por duke parë ofertat e shumta, drejtuesit mund ta sakrifikojnë në këtë sezon merkatoje. Udinese, Sassuolo, Gallatasaraj, Everton dhe Kristal Pallas, kanë shfaqur interes dhe janë gati të bëjnë një ofertë për 24-vjeçarin, i cili ka kontratë deri në vitin 2019 me Fiorentinën.

Fellaini i bashkohet Mojesit?

Marouane Fellaini me shumë mundësi do t'i thotë lamtumirë Mançester Junajtedit gjatë kësaj merkatoje. Mesfushori, i cili më parë ka refuzuar ofertën e drejtuesve të “Djajve të Kuq” për rinovimin e kontratës, mund të transferohet te skuadra e Uest Hem. Ekipi i drejtuar nga David Mojes kërkon përforsime për sezonin e dytë të kampionatit dhe belgu shikohet si alternativa e duhur për repartin e mesfushës.



DASHI 21. mars - 20. prill

Sot shqetësimi mund t'ju çojë që të silleni ashpër me partnerin/en tuaj. Ata që janë të pakënaqur me jetën e tyre emocionale do të kërkojnë strehim diku tjetër.



DEMI 21. prill - 21. maj

Me Hënën në anën tuaj do të jeni më tërheqës dhe mundësitë shumëzohen për të pasur vëmendjen e atyre që janë të interesuar për ju.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Sot Hëna ju jep një frymë të lumtur, e cila do t'ju bëjë të kaloni ditën në mënyrën më të mirë. Dashuria dhe erosi ecin krah për krah dhe ju do të jetoni ndjenja intensive!



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Ju nuk do t'ju mungojë guximi për të kapërcyer pengesat. Ju jeni të aftë dhe të zgjuar, mund të ktheni çdo situatë në favorin tuaj, madje edhe ato sentimentale.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Është më mirë të mos bëni gjykime për një partner/e që nuk e njihni mirë, prisni para se të bëni një vlerësim për të.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Një ditë me sentimentalizëm të madh emocional. Ju do të dëshiroheni dhe kërkoheni nga partneri/ja juaj dhe kjo do t'ju mbush me gëzim.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Fillimi i javës nuk do jetë i mirë për shumë prej jush, grindjet e nxitura nga Mërkuri dhe Marsi armiqësorë nuk do t'ju ndalojnë të përballeni me partnerin/en tuaj dhe të gjeni një marrëveshje.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Në dashuri do të duhet të bësh gjithçka për të rifituar vëmendjen e partnerit/es. Pasi të kërkonti falje për ndonjë gabim që mund të keni bërë pa e kuptuar do ju kthehet paqja në çift.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Gjatë kësaj të hëne do t'ju përfshijë ndjenja e stresit, e karakterizuar nga ngjarje të papritura dhe surpriza. Në fushën e dashurisë, mbështetuni në ëmbëlsinë për të marrë atë që dëshironi nga i dashuri/a juaj.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Për ju Bricjap fillon një javë interesante, jeni duke bërë një përzgjedhje midis njerëzve në anën tuaj dhe atyre që nuk janë. Në mbrëmje do të përmirësoni marrëveshjen me të dashurin/en.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Edhe nëse Marsi dhe Jupiteri ju kthejnë shpinën, marrëdhëniet me partnerin/en tuaj gjithmonë mund të përmirësohen falë një dialogu të hapur dhe të sinqertë.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të jetë një ditë e karakterizuar nga shqetësimi ose nga zemërimi i shkaktuar nga keqkuptimet me partnerin/en. Vetëm bëni gjërat që besoni për të mos shkuar në krizë.




Table with columns: MENSUR MAMUTI, LLOJ FORDI, SHIH FOTON, SINUS, AKTORI AMERIKAN, MARKË CELULARESH, FLORI, PERIUDHA E SUKSESSHME GJATE NJË VEPRIMTARIE. Rows include: QË ËSHTË FIS ME DIKË, VALËZUESJA E FAMSHE AMERIKANE, DANKAN, ADASH, SARAJEVË, TELECOMMUNICATIONS INDUSTRY OMBUDSMAN, MASIV MALOR NE EVROPE, KOHA, VENDVDEKJA E I.O. (24 janar 1919), RAJONI I EMIRIT (sh.pashq.) VEPRIM (lat.), UDHËHEQËSI MË I MADH I PADISHAHUT, RESTORANTET UNIVERSTARE, LLOJ VJERSHE (kushuar guas së zemrës), KËNGËTARI IGLESIAS (I BIRI I HULIOS), AZOT, GJIMNAZI DHE QYTETI KU MESOI I.O., ZINHIR MALESH NË TURQI, TETOVË, KOHA, IMPULS, INSTITUCIONI ARSIMOR.

Table with columns: QYTET NË KALIFORNI ... DIEGO, TË DHËNAT E VENDBANIMIT, LUMË NË SHQIPËRI, KËNGËTARI I TË 80-ave, ESTLI, RAJONI I EMIRIT (sh.pashq.) VEPRIM (lat.), UDHËHEQËSI MË I MADH I PADISHAHUT, RESTORANTET UNIVERSTARE, LLOJ VJERSHE (kushuar guas së zemrës), KËNGËTARI IGLESIAS (I BIRI I HULIOS), AZOT, GJIMNAZI DHE QYTETI KU MESOI I.O., ZINHIR MALESH NË TURQI, TETOVË, KOHA, IMPULS, INSTITUCIONI ARSIMOR.

ZGJIDHJET: FISANAK, ISIDORA, EMNAK, RR, SA, MISHI, TIO, AAF, ALPE, RR, QEPALLA, PERUXHA, EMIRATE, SADRAZAM, MAC, MADRIGAL, TINI, ENRIKE, B, R, EL, N, EN, RIEKAS, T, ZOSIMEA JANINE, ALA, A, TV, STAR, TE, ANTILOPAT KEVIN, OTO, AT, I, KULTURORE, R, SHKOLLA, PANTOLLE.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

Sudoku grid 1: 4 9 2 3 5 8 1 7 9 6 8 3 4 6 6 2 9 5 3 6 8 7 1 5 2 4 6 9 5 3 5 3

Sudoku grid 2: 9 3 7 9 6 1 8 4 7 6 8 7 1 2 4 8 3 4 5 8 1 4

Shumë i lehtë: 468231579, 793546218, 251798346, 985324761, 634187952, 127965834, 346879125, 812453697, 579612483, Mesatar: 796135482, 125498376, 384672159, 918243765, 452867931, 673519248, 867321594, 249756813, 531984627.

Australi, nga qielli po bien lakuriqë “të zierë”

Ndërkohë që SHBA-ja përballet me kushte ekstreme të të ftohtit, në anën tjetër të botës, në Australi, popullsia është goditur një valë e paparë e temperaturave të larta, duke shkuar deri në 47 gradë Celsius. Për shkak të temperaturave të larta vlerësohet të kenë kanë ngordhur 200 deri 1 mijë lakuriqë, vetëm në fushën e Campbeltown në New South Wales, ku vendasit u zgjua me një skenë të tmerrshme. Vullnetarja Cate Ryan nga Park St Helens tha se erdhi për të parë lakuriqët e ngordhur që binin nga qielli sikur të ishin të zier, për shkak të temperaturave ekstreme. “Pash qindra lakuriqë të ngordhur. Binin në tokë dhe ngordhin”, tha ajo. Temperatura në Campbeltown ka arritur në mbi 44 gradë Celsius, ndërsa në vende të tjera dhe Parramata



Penrith, ku temperatura arriti në 47.3 ° Celsius, ndikoi që edhe asfalti nisi të shkrijë. “Lakuriqët, thënë tekstualisht, po zihen. Temperatura ndikon në trurin e

lakuriqëve dhe aftësitë e tyre bëhen të dobëta. Është sikur një njeri qëndron për orë të tëra i ekspozuar në diellin e shkretëtirës”, shpjegojnë shkencëtarët.



Dua Lipa “princesha” e re Disneyt

Dua Lipa ka shpërthyer me videoklipin e saj të fundit “IDGAF”, por përkundër kësaj ajo ka inspiruar edhe artistët e tjerë. Artistja braziliane Mayhara Ferraz e ka shndërruar Dua Lipën në princeshë të Disneyt, duke ilustruar portretin e saj nga videoklipi i fundit. “IDGAF”, që u lansua para dy ditësh, ka arritur 10 milionë klikime gjë që ka emocionuar mjaft shumë këngëtarën me prejardhje shqiptare. “IDGAF” ka arritur 10 milionë klikime në 48 orë, wahoo. Plus Mayhara Ferraz më ka shndërruar mua në princeshë të Disneyt”, ka shkruar Dua Lipa në Instagram.



McLaren 24 karat dhe klienti misterioz

Mes krijësive të fudit të McLaren Special Operations është dhe një model unik, 720S i prezantuar në Sallonin e Dubait, me kërkesë të një klienti misterioz. Ndryshon vetëm estetika pasi është njësoj nga ana mekanike s modeli Super Series, me motor me 8 cilindra biturbo 4.0 me 720 kuaj fuqi, projektuar nga italianin Emilio Scervo. Shasia është me fibra karboni. Përveç karbonit, disqet në ngjyrë ari për të përcaktuar im-

paktin viziv. 120 orë punë më shumë janë dashur se modeli origjinal, për të personalizuar këtë mjet. Një tjetër e veçantë e këtij mjeti është shprehja pas e shkruar me shkronja arabe. “Jeta matet me atë që arrin, duke mos numëruar vetëm vitet”, fjalë të Bruce McLaren, themeluesit të kompanisë. Citimi ka kërkuar 30 orë punë për pozicionin e veçantë dhe dizajnin e veçantë që formon grataçielat e Dubait në ngjyrë ari.



Jam përdhunuar kur isha 12 vjeçe

Në këto kohë po përfliten më shumë se asnjëherë tjetër në Hollywood për ngacmimet dhe abuzimet seksuale. Ndoshta juve nuk ju kishte shkuar në mendje, por edhe një aktore shqiptare e njohur në botë, ka vuajtur një abuzim seksual kur ishte vetëm 12 vjeçe. Përmes një statusi në Facebook, Eliza Dushku ka shkruar historinë e rëndë që ka përjetuar kur ishte fëmijë. Dushku tregon se ngjarja ka ndodhur kur ajo xhironte filmin “True Lies”, dhe një prej kordinatorëve kryesorë të

efekteve speciale në Hollywood, Joel Kramel ka abuzuar me të. “Më kujtohet si sot para 25 viteve, kur Joel më bëri të ndihem e veçantë dhe ndërtoi te unë dhe prindërit e mi besimin si të qe mik familjeje. Kështu, i mbushi mendjen babait tim të më çonte me pushime në Miami dhe më kujtohet aq mirë se si më dha drekën me sushi. Më pas uli dritat e dhomës, uli temperaturën e kondicionerit dhe më vendosi një film në dhomën me një shtrat. Më pas iku në tualet dhe kur u kthye ishte totalisht i zhveshur. Më pas më shtriu në shtrat dhe filloi të më fërkonte. E më tha: Oh, ti mos bëj sikur nuk të pëlqejnë hret e mia”, shkruan Eliza në Facebook.

550 - Lufta e Gotëve (535-552): Ostrogotët, nën udhëheqjen e mbretit Totila pushtojnë Romën pas një rrethimi të gjatë.

1219 - Vërshimet në Holandën Veriore pas një stuhie të madhe. Gjatë atyre vërshimeve vdesin rreth 1000 njerëz.

1493 - Kristofor Kolombo kthehet në Spanjë pas udhëtimit të tij të parë.

1556 - Perandori Karl emëron të birin e tij Filipin II, mbret të Spanjës.

1756 - Anglia dhe Prusia nënshkruajnë Traktatin e Westministerit

1759 - Hapet Muzeu britanik në Londër.

1777 - Vermonti shpall pavarësinë nga Nju Jorku.

1950 - Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda njohin Izraelin.



1980 - Arrestohet Paul McCartney në Tokio për 10 ditë për shkak të posedimit të

marihuanës

1989 - Policia arreston shkrimtarin Vaclav Havel në Pragë.

1991 - SHBA dhe 27 vende aleate sulmojnë Irakun për shkak të okupimit të Kuvajtit.

Përbëjnë vetëm 10% të popullsisë në botë. Në dekadat e fundit ka pasur shumë teori se pse disa njerëz janë majtak. Një hulumtim i bërë nga viti 1980 tregon se kjo varet nga niveli i stresit të nënës gjatë shtatzënisë. Stresi gjatë javës së tetë të shtatzënisë së nënës është vetëm fillimi, kurse gjithçka vendoset nga java e 13 fo-shnjat kur fillojnë të thithin mëlçinë ose gishtin e dorës së djathtë. Më parë u konsiderua se shkak për këtë fenomen janë dallimet gjenetike mes hemisferës së majtë dhe të djathtë të truri, që përcaktojnë nëse fëmija do të jetë majtak apo djathtak.



DASHURIA E BURRIT

Veterineri: Gruaja juaj është këtu me macen dhe kërkon t'i bëjë eutanazion (shkaktim i vdekjes në mënyrë mjekësore). Pajtoheni ju me këtë?

Burri: Po, patjetër. Kurse macen lëshojeni se di të shkojë vet në shtëpi.



Më mirë është të premtoni pak dhe të dhuroni shumë sesa anasjelltas. (Richard Branson)